



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 32 (827836)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 11 gusht 2023

Anija "Butrinti" në detin Egje, në shërbim të Aleancës për shpëtimin e jetëve njerëzore

Anija P-134 "Butrinti", pjesë e misionit "Sea Guardian" e grupit të anijeve të SNMG2 TU 01, mori pjesë në një operacion kërkim-shpëtimi (SAR), në bashkëpunim me Rojën Bregdetare të Turqisë dhe Rojën Bregdetare të Greqisë për një gomone me emigrantë, e cila ndodhej në vështirësi. Operacioni SAR përfundoi me sukses, duke

shpëtuar 30 emigrantë midis tyre gra dhe fëmijë. Emigrantët u morën nga Roja Bregdetare turke në gjendje të mirë shëndetësore dhe vazhduan drejt portit të Çesmes, Turqi për procedura të mëtejshme.

Forca Detare vazhdon detyrën e saj në shërbim të Aleancës, duke kontribuar në shpëtimin e jetëve njerëzore. >>> faqe 2



Zgjidh të ardhmen e sigurt, zgjidh FA, shërbe krah më të mirëve!



>>> faqe 3

Inteligjenca artificiale (AI) për sistemet e sigurisë dhe mbrojtjes kibernetike

Sistemet e sigurisë kibernetike në përgjithësi kanë fenomene të mbrojtjes pasive dhe paralajmërimeve të hershme. Duke synuar të njohim problemet e mësipërme, kjo çështje e re për ne vendos në dukje konceptin e paralajmërimit në kohë reale dhe planifikon një strategji mbrojtjeje të AI-së për sistem sigurie dhe mbrojtjes kibernetike të ndihmuar nga një ontologji e sigurisë. Për të kuptuar atë çka është pjesa...



>>> Faqe 4

Armët shqiptare, qëllim, art, identitet

Periudhat më të hershme historike shpeshherë flasin me objekte, monumente dhe artefakte të ngjarjeve apo dhe personave të rëndësishëm historikë. Historisë së Ali Pashë Tepelenës, edhe pse e dokumentuar mirë përmes udhëpërshkrimeve apo tanimë së fundi edhe nga dokumentacioni i botuar, i mungojnë objekte të veçanta të Pashait Tepelenas që do të mund të përshkruanin dhe rrëfenin më mirë epokën kur ai jetoi dhe veproi...



>>> Faqe 6

Arti shqiptar, thesari i vlerë i brigjeve joniane

Gjurmët më të hershme. Fillimet e artit figurativ në truallin e Shqipërisë janë të hershme. Gjurmët e para i përkasin periudhës së neolitit. Nëpërmjet zbulumëve të shumta arkeologjike, në zona të ndryshme të vendit, janë gjetur qindra e mijëra qeramika, terakota, zbukurime ne metal etj, që u përkasin fiseve ilire, paraardhësve të drejtpërdrejtë të shqiptarëve të sotëm. Prodhimet më të hershme janë të thjeshta, për përdorim praktik, por në to shfaqen edhe vlera artistike si në format zoomorfe të enëve ashtu edhe në dekoracionin, gdhendjet dhe elemente të tjerë. Nga...



>>> Faqe 12

Anija "Butrinti" në detin Egje, në shërbim të Aleancës për shpëtimin e jetëve njerëzore

Anija P-134 "Butrinti", pjesë e misionit "Sea Guardian" e grupit të anijeve të SNMG2 TU 01, mori pjesë në një operacion kërkim-shpëtimi (SAR), në bashkëpunim me Rojën Bregdetare të Turqisë dhe Rojën Bregdetare të Greqisë për një gomone me emigrantë, e cila ndodhej në vështirësi.

Operacioni SAR përfundoi me sukses, duke shpëtuar 30 emigrantë midis tyre gra dhe fëmijë.

Emigrantët u morën nga Roja Bregdetare turke në gjendje të mirë shëndetësore dhe vazhduan drejt portit të Çesmes, Turqi për procedura të mëtejshme.

Forca Detare vazhdon detyrën e saj në shërbim të Aleancës, duke kontribuar në shpëtimin e jetëve njerëzore.



Regjimenti i Operacioneve Speciale (ROS), i cili në përbërjen e vet ka dy formacionet më të rëndësishme të Forcave të Armatosura, me një histori të gjatë kontributesh dhe suksesi me efektivë të mirë trajnuar, të aftë për të realizuar çdo mision, janë duke u stërvitur për të vënë në praktikë njohuritë e tyre planëzuese dhe taktike për rritjen e mëtejshme të aftësive operationale.



STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Zgjidh të ardhmen e sigurt, zgjidh FA, shërbe krah më të mirëve!

Akademia e Forcave të Armatosura ka kontribuar në përgatitjen e shumë brezave të lidhshpimit ushtarak, në zhvillimin dhe konsolidimin e Forcave të Armatosura dhe zhvillimin e mendimit shkencor ushtarak. Të diplomuarit prej saj sot përfaqësojnë drejtues të lartë ushtarakë, gjeneralë, studiues të fushave të ndryshme, politikanë, diplomatë, kryetarë shteti, drejtues në botën e biznesit dhe shoqërisë civile.

Arsimimi Ushtarak, sjell programe mësimore në përgjigje të zhvillimeve gjeopolitike, në sinergji me kërkesat e strategjisë së sigurisë për mbrojtjen e interesit kombëtar.

Akademia e Forcave të Armatosura, është institucioni arsimor ushtarak me formim euroatlantik, me bilanc të pasur pedagogjik, me kërkim shkencor të riorganizuar me bashkëpunim me institucione prestigjioze të Aleancës si "West Point" në SHBA, Qendra Amerikane e Studimeve Strategjike në Europë "Xhorxh Marshall" me qendër në Gjermani, me Akademinë Ushtarake të Romës, Akademi të tjera të vendeve euroatlantike, por dhe atyre partnere dhe vendeve të rajonit.

Akademia e Forcave të Armatosura ka përvojë të plotë në mësimdhënie, punë kërkimore – shkencor, që e dallojnë si institucion elitare të Mbrojtjes dhe Sigurisë në vend.

Arritjet e saj reflektohen tek produkti real i veprimtarisë 65-vjeçare, ku janë diplomuar më shumë se 8200 ushtarakë oficerë dhe civilë.

Reformat në strukturën arsimore ushtarake, hartimi i politikave, strategjive dhe projekteve flet qartë për rëndësinë e Akademisë së Forcave të Armatosura. Forcat e Armatosura, një pasqyrë e shoqërisë shqiptare dhe proceseve që kalon vendi, kanë nevojë për udhëheqës ushtarak që kuptojnë marrëdhëniet midis qeverisjes demokratike nga njëra anë dhe sigurinë e stabilitetin kombëtar dhe rajonal nga ana tjetër.

Akademia, si përgjegjëse për arsimimin e udhëheqësve të lartë ushtarakë, synon përshtatjen e një filozofie arsimimi që rrënjosh shprehinë e të menduarit për çështjet e sigurisë dhe sfidon studentët të vlerësojnë me kujdes dinamikën e mjedisit të sotëm të sigurisë me mjetet/teknikat e mendimit kritik, aq të domosdoshëm për një udhëheqës të nivelit të lartë ushtarak.

Sot ti zgjedh të ardhmen tënde të sigurt në FA Akademia e Forcave të Armatosura është një mundësi fantastike për çdo maturant që synon një arsimim dinjitoz e cilësor.

Mundësi përzgjedhje në një nga 3 degët e Bachelorit të ofruar nga kjo akademi:

• **Marrëdhënie Ndërkombëtare në fushën e Mbrojtjes**

• **Teknologji Informacioni dhe Komunikim në fushën e Mbrojtjes**

• **Shkenca Komunikimi në fushën e Mbrojtjes**
Me një program të avancuar të studimeve Bachelor, Akademia ofron një kombinim të shkëlqyer të edukimit akademik dhe trajnimit ushtarak.

Ju keni mundësi të studioni në një nga programet që ofron Akademia e Forcave të Armatosura, duke plotësuar formularin A2 në portalin UAlbania link:

- Marrëdhënie Ndërkombëtare në fushën e Mbrojtjes - 20 kuota
- Teknologji Informacioni dhe Komunikim në fushën e Mbrojtjes - 20 kuota
- Shkenca Komunikimi në fushën e Mbrojtjes - 20 kuota



BËHU VERSIONI YT MË I MIRË!

BËHU PJESË E FORCAVE TË ARMATOSURA
PËR NJË KARRIERË UNIKE

Koha për të ndryshuar jetën tuaj dhe për të kaluar në një fazë tjetër të re, atë të jetës studentore po afrohet. Jeni gati për të nisur këtë rrugëtim, drejt së ardhmes tuaj, për të zgjedhur profesionin, i cili nesër do t'ju përcaktojë dhe rolin në shoqëri. Për të gjithë ju maturantë që ende nuk keni vendosur për një program studimi, ejani dhe bëhuni pjesë e FA-së, duke përfutur nga privilegjet që i gjen vetëm duke u bërë pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

- Pagesë mujore ndihmëse për çdo student për të

gjithë periudhën e studimit;

- Akomodim dhe ushqim falas për 4 vitet e studimit në Akademi;

- Tarifë studimi 0 lekë në vit;

- Punësim i sigurt pas përfundimit të studimeve;

- Mundësi studimi në programe Master dhe trajnime në fusha të ndryshme në akademitë më të mira në vendet e BE-së, në UK dhe USA. (bursa)

Bëj zgjedhjen e duhur, duke aplikuar në Akademinë e Forcave të Armatosura, për atdheun, familjen, të ardhmen tënde të sigurt.



N/KOL (R) MSC. KANAN HIMAJ

Inteligjenca artificiale (AI) për sistemet e sigurisë dhe mbrojtjes kibernetike



Sistemet e sigurisë kibernetike në përgjithësi kanë fenomene të mbrojtjes pasive dhe paralajmërimeve të hershme. Duke synuar të njohim problemet e mësipërme, kjo çështje e re për ne vendos në dukje konceptin e paralajmërimit në kohë reale dhe planifikon një strategji mbrojtjeje të AI-së për sistem sigurie dhe mbrojtjes kibernetike të ndihmuar nga një ontologji e sigurisë. Për të kuptuar atë çka është pjesa e rëndësishme shpjegojmë se: ontologji në sistemet e informacionit është një strukturë e përbërë nga një grup konceptesh dhe kategorish, që lidhen me një fushë të caktuar të njohurive si dhe informacioneve. Në kontekstin e sigurisë së informacionit, mund të flasim për kiberontologji (ka në bazë fjalën “kibernetike”, shkencë mbi komunikimin mes qenieve të gjalla dhe makinave) ose ontologji të sigurisë kibernetike. Ato nënkuptojnë gjithashtu një strukturë të dhënash, bazat e njohurive mund të mbajnë fakte të pa strukturuar. Nga ana tjetër, një taksonomi (praktika dhe shkenca e klasifikimi) është klasifikimi i objekteve dhe rregullimi i tyre në një hierarki, ndërsa ontologjia përshkruan vetitë dhe marrëdhëniet e tyre.

Së pari, ne parashikojmë një ontologji të mbrojtjes së sigurisë që integron ndërtimet sipas grafikëve të sulmeve, qëllimet e përgjithshme dhe bazat e njohurive specifike për fushën, dhe mbi këtë bazë zhvillojmë një metodë të drejtuar nga ontologjia të paralajmërimeve të hershme të sulmeve në kohë reale që mbështet zbulimin me skanim ndërhyrës, kombinon planifikimin e inteligjencës artificiale dhe racionalitetin e kufizuar për të rekomanduar strategjitë e mbrojtjes në skenarët e mbrojtjes konvencionale. Eksperiencia dhe përvoja nuk mungon, shumë prej vendeve partnerë kanë kryer studime dhe rezultatet tregojnë se metoda e propozuar mund të analizojë shpejt të dhënat e trafikut të rrjetit për paralajmërime në kohë reale të sulmeve. Metoda e propozuar është shumë e realizueshme dhe ka aftësinë për të zbatuar strategjitë e mbrojtjes në mënyrë autonome dhe performon më së miri, me një rritje të efektivitetit të mbrojtjes. Në përgjithësi, kjo metodë ka potencialin për të rritur efektivitetin e mbrojtjes kundër sulmeve kibernetike nën kufizime të larta të burimeve kompjuterike.

Sulmet në hapësirën kibernetike përbëjnë një kërcënim serioz për shkak të pragut të tyre të ulët dhe kohës e rastësishme dhe të shkurtër të sulmit. Paralajmërimit e hershme dhe të shpejta, zbatimi i strategjive të synuara të mbrojtjes janë çelësi për minimizimin e humbjeve. Sistemi i sigurisë kibernetike zakonisht ndërtohet në mënyrë sinkrone me sistemin e informacionit, dhe është sfiduese për ta përshtatur atë me zhvillimin e shpejtë të metodave të sulmeve.

Modeli i mbrojtjes së sigurisë ka kufizime të dukshme me mbrojtjen pasive të hershëm paralajmërimet për rreziqet. Prandaj, në kushtet e kufizuara të kohës, njohjes dhe informacionit të kibernetikës për skenarët e sigurisë, efektiviteti i mbrojtjes së sigurisë është i vështirë të garantohet.

Krijimi i njohurive të sigurisë dhe mbrojtjes, për ne mbetet shumë e rëndësishme njohja e sistemeve të inteligjencës së kërcënimeve, e cila bëhet bazë për zbatimin e mbrojtjes aktive. Teknologjia aktuale e sigurisë është futur në epokën tonë të inteligjencës dhe arsytimi i strategjisë së sigurisë kërkon themelimin e

shprehjeve të njohurive të formatizuara dhe të standardizuara. Kështu, integrimi i njohurive është thelbësor dhe i përshtatshëm për skenarë specifikë të sigurisë. Midis tyre, duhet më shumë informacion rreth njohurive, të tilla si ato të përgjithshme dhe të përfshirë në dukuritë e sigurisë, të cilat të shërbejnë për t'u përdorur sistemi i njohurive të sigurisë. Prandaj, një teori e fortë themeli për mbrojtjen kibernetike mund të arrihet me përkufizime të sakta tëtributeve të sigurisë dhe marrëdhëniet e tyre në sistemin e sigurisë. Këto teori duhet të përpunohen dhe të zhvillohen gjerësisht edhe në sistemin arsimor publik dhe privat, në mënyrë të veçantë në Akademinë e Forcave të Armatosura, ato mund të jenë dhe tema të mirëfillta studimore me theks sigurinë dhe mbrojtjen e vendit.

Paralajmërimet e hershme të sigurisë janë premisa për mbrojtjen aktive të sigurisë kibernetike dhe themeli për zbatimin e programeve të sigurisë, të cilat synojnë të zbulojnë sulmet kibernetike më herët që të jetë e mundur dhe të japin alarme të hershme përpara se asetet të pësojnë dëme të konsiderueshme. Duke kryer zbulimin në fazën e fillimit të sulmit është çelësi për siguri të optimizuar në strategjitë e mbrojtjes. Dizajni ideal duhet të jetë në gjendje të analizojë dhe të kapë të dhëna bazë (të tilla si trafikut të rrjetit) në fazat e hershme të sulmeve. Kapja e trafikut të rrjetit dhe analiza e thellë e informacionit është thelbësor për paralajmërimet e hershme të sulmit (siç është skanimi mbi sulmet).

Qëllimi përfundimtar i mbrojtjes aktive është arritja e qëllimeve të sigurisë bazuar në strategjinë e mbrojtjes. Në mënyrë që të parandalohet ndikimi i ndërhyrjes para se të shkaktojë dëmtim të sistemit, është e nevojshme të ndërtohet një sistem mbrojtës elastik dhe të miratohet metoda e mbrojtjes për të zbatuar strategjinë e duhur. Kjo do të ndihmojë në shmangien dhe zvogëlimin e rreziqeve me të cilat përballen sistemin e informacionit. Planifikimi i strategjisë së mbrojtjes fillimisht duhet të përcaktojë masat e sigurisë që kërkohen nga asetet dhe më pas rekomandon përgjegjësitë e mbrojtjes mbi këtë bazë. Prandaj, është e nevojshme të sqarohet siguria e funksioneve të asetëve, në të cilat rëndësia e matjes së tyre, që lidhen ndaj qëllimeve të këqija, të cilat janë premisa, dhe si të rekomandohet një mbrojtje e mirë sipas faktorëve ekzistues të rreziqut. Duke marrë parasysh shumë kushtet e kufizuara

dhe të normalizuara të kohës, njohjes dhe informacionit në skenarët e sigurisë, si të zbatohet mbrojtja aktive dhe inteligjente nën kufizime të larta të burimeve kompjuterike dhe kushtet dinamike të mjedisit të asetëve janë një tjetër problem. Nisur sa më lart mund të sugjerojmë një ide për mbrojtjen kibernetike për një mekanizëm planifikimi AI, bazuar në ontologjitë e sigurisë. Kontributet kryesore të këtij studimi mund të jenë me efekte pozitive si: sipas njohurive tona, propozimi realizon një paralajmërim në kohë reale dhe sistem autonom i mbrojtjes nën kufizime të larta të burimeve kompjuterike dhe kushtet e mjedisit të asetëve, duke përdorur racionalitetin e kufizuar dhe planifikimin e AI-së. Tjetër, krijohet një



ontologji e sigurisë si një sistem njohurish për sigurinë, i cili zyrtarizohet dhe standardizon njohuritë me shumë burime dhe ofron një grafik të njohurive për arsytimin e strategjisë së mbrojtjes. Ontologjia e sigurisë gjithashtu lehtëson zbulimin e sulmeve të skanimit dhe ofron efikasitet në fillim dhe paralajmërimet për mbrojtje aktive në fazën e hershme të sulmeve. Mbrojtja kibernetike paraqet një trend zhvillimi aktiv dhe inteligjent.

Qasjet paralajmëruese, shpesh merret një model sulmi për të zbuluar sjelljet jonormale nga krahasimi me modelet normale sepse: qasjet

dhe zgjidhjet praktike ndaj sulmeve mund të zbulohen nga metodat e marrjes së të dhënave për të gjeneruar paralajmërime të hershme sulmi; teknologjitë e rrjeteve algoritmet e përzgjedhjes së veçorive mund të ofrohen për të mësuar modelet sulmuese dhe identifikojnë ndërhyrjet në mënyrë efektive.

Gjithashtu ky shkrim nxitet nga punimet e sipërpërmendura, dhe synon të trajtojë çështjet e hapura në fushën e kërkimit të mbrojtjes kibernetike nëpërmjet teknikave të inteligjencës artificiale për paralajmërimet e hershme të sulmit dhe mbrojtjen inteligjente aktive. Veç sa më lartë ai zbulon sulmet e hershme, duke analizuar informacionin origjinal, duke zbatuar strategjitë e mbrojtjes kibernetike të bazuara mbi ontologjinë e sigurisë që lidhet me informacionin heterogjen me shumë burime. Objektivi kryesor i këtij shkrimi është të mundësojë paralajmërimet të hershme në kohë reale dhe zbatimin e strategjisë autonome të mbrojtjes nën burime të kufizimeve kompjuterike si kontrast me veprat ekzistuese.

Duke synuar problemin e inteligjencës pasive të mbrojtjes së sigurisë në rrjedhën aktuale në rrjetet për sistemet e sigurisë, shkrimi ka një qasje të planifikimit të AI-së për strategjitë e paralajmërimit dhe mbrojtjes në kohë reale për sistemet e sigurisë kibernetike të ndihmuara nga siguria e ontologjisë. Arsytimi logjik të sjellë zbatimin në paralajmërimet e hershme të sulmeve në kohë reale nëpërmjet informacionit të paketës së integruar të sigurisë. Planifikimi i AI-së dhe racionaliteti i kufizuar përdoren për të zbatuar mbrojtje aktive dhe inteligjente kibernetike në një kohë shumë të kufizuar, njohja dhe kushtet e informacionit për të lehtësuar problemet e sigurisë të shkaktuara nga të lart, kufizimet në burimet llogaritëse dhe mjediset dinamike të asetëve. Së fundi,

mund të theksojmë se aty ku janë realizuar studimet ka rezultuar se rezultatet eksperimentale tregojnë analizën e të dhënave të trafikut të rrjetit, i cili është efektiv për paralajmërimet e sulmeve dhe metodat e propozuara janë të realizueshme dhe mund të planifikohen në mënyrë të pavarur për strategjitë e sigurisë dhe mbrojtjes. Në këto kushte edhe pse në hapat e para për sistemin tonë të mbrojtjes, teorinë dhe përvojat e lartpërmendura do të shërbejnë për të rritur ndjeshëm efektivitetin e mbrojtjes kundër sulmeve kibernetike nën kufizime të larta të burimeve kompjuterike.

Elham Kondo, skënderbegasi me medalje ari në Akademinë e Moskës

Elham Kondo ishte një nga nxënësit e Shkollës së Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, që në karrierën e tij të gjatë në Forcat e Armatosura, i janë besuar detyra të rëndësishme në funksione komanduese dhe politike. Krahas detyrave të larta në aparatit të Ministrisë së Mbrojtjes, për një periudhë, Elham Kondo ka kryer dhe detyrën e Komisarit të Korpusit. Ndonëse me aftësi intelektuale e përgatitje të mirë ushtarake, karriera e tij ka pasur dhe ndëshkime, që lidhen me uljen në detyrë për mos efektivitet ndaj goditjes së të quajturit “Grup armiqësor në ushtri, i drejtuar nga Beqir Balluku”.

Elham Kondo lindi në Vlorë, më 18 shtator të vitit 1930, ku ka ndjekur dhe vitet e para të shkollimit.

Në vitin 1947, ai nis studimet në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, e cila i kishte hapur dyert vetëm dy vite më parë. Studimet në këtë institucion arsimor ushtarak, i përfundon me rezultate shumë të mira në vjeshtën e vitit 1947.

Në periudhën 1947-1951 ai kryen studimet në Shkollën e Bashkuar të



Foto ilustruese

Oficerëve në Tiranë, në përfundim të së cilës, titullohet “Oficer aktiv”. Vetëm një vit kryen detyrë komanduese në nënrepart, pasi në vitin 1948, ai ulet përsëri në bankat e shkollës, (viti 1952),

këtë radhë në Shkollën e Lartë të Partisë në Tiranë. Studimet në këtë institucion arsimor të kohës, vazhduan dy vite, përkatësisht në periudhën 1952-1954.

Në vitin 1955, Elham Kondo

dërgohet për studime në Akademinë Politike Ushtarake “Vladimir Iliç Lenin” në Moskë të ish-Bashkimit Sovjetik.

Në vitin 1960, ai përfundon studimet

në këtë akademi duke u vlerësuar me “Medalje të Artë” dhe rikthehet në atdhe, në detyra funksionale të edukimit në strukturat e mbrojtjes.

Në vitin 1970-1971, ai kryen dhe Kursin e Lartë të Filozofisë pranë Shkollës së Partisë “V. I. Lenin” në Tiranë. Për sa i përket karrierës së tij, siç u theksua më lart, është kryesisht në sektorin politik: Përgjegjës i rinisë në Regjiment (1951-1953); shef i degës së rinisë në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha në Tiranë” në periudhën 1953-1955; propagandist regjimenti dhe lektor në Drejtorinë Politike të Ushtrisë në periudhën 1960-1962; shef i aparatit politik në Shkollën e Aviacionit në Vlorë dhe shef i aparatit politik në Mbrojtjen Kundër Ajrore (MKA) në vitet 1962-1967; komisar i Korpusit të Shkodrës në vitet 1971-1973. Në vitin 1973, në kuadër të goditjes së një sërë të kuadros madhorë në kuadër të “Grupit puçist në ushtri” të kryesuar nga Beqir Balluku, ulet në detyrë dhe punon si komisar grupi. Në vitin 1986, nxirret në lirim. Në karrierën e tij në Forcat e Armatosura, ai ka merituar katër medalje dhe dy urdhra.

IN MEMORIAM

Hyseni Repa u lind në Fushë-
Alie, Dibër, në vitin 1938 dhe u nda nga jeta në Tiranë, më 22 janar të vitit 2019. Shkollën 7-vjeçare e kreu në Shkodër, ndërsa në Tiranë kreu shkollën ushtarake “Skënderbej” në vitet 1962-1966). Pastaj kreu Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike (1967-1972). Pas kryerjes së studimeve të larta, punoi si pedagog i lëndës së mekanikës në shkollën ushtarake “Skënderbej” (1972-1975), shef i Oficinës dhe shef i Degës Teknike në Shkodër (1975-1992).

Në periudhën 1992-1994, kreu detyrën e instruktorit në Drejtorinë e Autotraktorëve në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në vitet 1994-1997, ishte zëvendës drejtor në Drejtorinë e Logjistikës. Nga marsi 1997 deri në shtator 1997, qe komandant i Divizionit të Këmbësisë në Shkodër. Mbas ndryshimeve të viteve ‘90-të, u gradua gjeneral në ushtrinë shqiptare.

Me dekret të Presidentit të Republikës nr. 2155, datë 16 maj 1998, ulet në gradë dhe me urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 2362, datë 24 korrik 1998, u nxor në rezervë. Gjeneral Hysen Repa ndërroi jetë në moshën 71-vjeçare.

Ja si janë shprehur disa prej

Gjeneral Hysen Repa, inxhinieri novator që la pas emrin e njeriut të mirë



kolegëve dhe miqve të tij pas ndarjes nga jeta: Haziz Keta, kolonel në lirim: “Njohja ime me Hysen Repën ka qenë e vonë, por ruajtëm komunikimin sepse na bashkonte jo vetëm Dibra... Hysen Repa, ishte dhe i gjithë ushtrisë, Shqipërisë. Hysen Repa, nuk la pengje, por nishane njerzillëku mençurie dhe pedagogun e shkencave ekzakte. Dhe nuk iku si hije por me respektin e merituar të një dibrani të zgjuar,

kuadër elitë në fushën e tij. Na la një emër tek “Logjistika është shkencë” (Bulica), ku aty është dhe një emër i përveçëm: Hysen Repa! Sepse ishte dhe do mbetet ndër personalitetet më të larta të logjistikës ushtrisë”.

Demir Osmani, inxhinier: “Hysen Repa ishte gjeneral i veçantë, pasi kishte parashitesën inxhinier. Hysen Repën e njoha si një nga personalitetet e larta të Ministrisë së Mbrojtjes të

Shqipërisë, një intelektual me virtyte të larta morale, një atdhetar i flaktë dhe kontributor i vazhdueshëm për lartësimin e figurës së ushtarakut dhe intelektualit shqiptar. Ruaj kujtime shumë të bukura nga ky burrë i mençur, i drejtë, besnik dhe shumë i zoti, që me sjelljen dhe cilësitë e larta morale që manifestonte, zbukuronte Dibrën dhe gjithë Shqipërinë”.

Illir Seci: “Gjeneral Hysen Repën e kam njohur në Shkodër. Ai ishte mishërimi i urtisë proverbiale dibrane, burrë i matur, fjalëpakë, i ditur, njeri që e dëgjonte me durim gjithkënd e nuk ia ndërpriste kujt fjalën. Qysh në vitet ‘70-të kishte mësuar në mënyrë autodidakte tri gjuhë të huaja, rusisht, anglisht, italisht. Gjithnjë kërkues me aq sa ishin mundësitë e asaj kohe, lexonte materiale në ato gjuhë për t’i vënë në dobi të ushtrisë shqiptare. Si inxhinier ai bëri mikrobusin e parë ushtarak sallë operacioni, 100 % funksionale, që mund të lëvizte në udhë të ngushta e rrugë të vështira nëpër prapavija, në rast lufte...”

Bujar Karoshi, gazetar, botues: “Sot ishte e shtunë. Herë pas here

ngrija kokën lart dhe prisja të dukej gjeneral Hyseni. Megjithëse e dija se nuk do të vinte, prapë besoja se mrekullitë ndodhin.

Kur uleshim jashtë pinte duhan dhe i shtrohej muhabetit. Dibrance. Shkurt. Me alegori. Me humor shkodran. Dëgjonte. Nuk kundërshtonte kurrë. Thoshte atë që mendonte shkurt dhe saktë dhe nuk mërzhitej. Fliste për gjithçka: për ushtrinë, diplomacinë, politikën, mekanikën, kasapin, librin, artin, muzikën, këngën popullore, jaren shkodrane, operën, Moxartin, Bahun, nëntëdhjetë e shtatën, luftën e Kosovës ... e deri te fëmijëria... Për gjithçka me dashuri dhe pasion.

...Të shtunën e parë të janarit nuk erdhi. E pritëm me Xhaferin dy të shtunat e tjera, por prap nuk erdhi. Nuk na shkonte mendja kurrë se ai po bëhej gati të ikte. Por iku siç nuk do ta kishte menduar kurrë: mbuluar me Flamurin që aq shumë iu përkushtua dhe e deshi dhe tre batara pushkësh në nderim të tij! Ti prehesh në paqe Hysen Repa! Sepse i paqtë, si rrallëkush ishte edhe mes nesh!

Marrë nga kolana “Skënderbegasit ndër vite”

Armët shqiptare, qëllim, art, identitet

Periudhat më të hershme historike shpeshherë flasin me objekte, monumente dhe artefakte të ngjarjeve apo dhe personave të rëndësishëm historikë. Historisë së Ali Pashë Tepelenës, edhe pse e dokumentuar mirë përmes udhëpërshkrimeve apo tanimë së fundi edhe nga dokumentacioni i botuar, i mungojnë objekte të veçanta të Pashait Tepelenas që do të mund të përshkruanin dhe rrëfenin më mirë epokën kur ai jetoi dhe veproi.

Në këtë drejtim Muzeu i Ali Pashës në ishullin e Janinës, ku ndodhen disa objekte origjinale të epokës së Pashallëkut të Janinës, por edhe të Ali Pashës, është një muze i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore, politike e sociale të pranisë së shqiptarëve në Epir.

Në tetor 2015, Muzeu i Ali Pashës në ishullin e Janinës, u pasurua me një pushkë origjinale të Ali Pashë Tepelenës, e cila është e larë në ar dhe ka të gdhendur, emrin e Ali Pashës dhe vitin 1804. Arma kishte qenë në zotërimin e një familjeje të vjetër fisnike nga Janina, që në vitin 1930 ishte shpërngulur në Athinë. Në fund të jetës, zotëria posedues që dëshiroi të mbetet anonim vendosi që t'ia dhuronte Muzeut të Ali Pashës, edhe pse për këtë objekt original mund të kishte marrë oferta nga shumë muze të botës. Arma e ekspozuar tashmë në muzeun e Ali Pashës në Janinë është e tipit karajfile. Pushka karajfile/e, është një dyfek i gjatë, që mbushej nga gryka dhe shkrehej me strall. Ajo kishte një tytë të gjatë dhe të hollë, shkrehej vetëm një herë dhe pjesën e pasme e kishte në formën e një koni. Kishte një namlli (tytë) 1,20-1.50cm të gjatë, brenda e jashtë të lëmuar dhe një çark që në pamjen e jashtme paraqet një grehës me strall (gurë xixash), përballë ngrehësit ndodhet një masat çeliku dhe nën të ndodhej kupëza e barutit. Qyta që mbështetej në sup të krahut në rast qitjeje quhej dipçik. Namllia mbërthehej në kondak me rripa teneqeje të verdhë. Nëpërmjet tytës dhe drurit futej harbia, e cila është një shufër hekuri e gjatë sa tyta dhe shërben për të mbushur pushkën. Pushka karajfile përdorej gjerësisht në kohët e vjetra, por sidomos gjatë

kohës së pashallëkut të Ali Pashë Tepelenës dhe në momentet e shpërthimit të Revolucionit Grek në vitin 1821. Dyfeku karajfile dallohet për stolisjet e shumta të bronzit por në armët që ishin në zotërim të elitës ushtarake dhe fisnike vendase, zbukurimet i kanë edhe me ar. Dyfeku karajfile ishte me origjinë dhe prodhim venecian dhe u përdor në Perëndim, kryesisht në fillimet e shekullit XVII deri nga mesi i shekullit XVIII.

Preferohej për tytat e gjera, të cilat mbusheshin kollaj nga të quajturat "plumba" ose "fishekët". Megjithëse arma karajfile, ishte e panevojshme në ushtritë e rregullta të Perëndimit, në duart e gjuajtësve dhe nishanllive të Lindjes, ishte shumë e çmuar. Pjesa e saj e pasme, kondaku, përdorej me efikasitet si çomange në raste nevojë. Pushka e krahut (karajfilja) ka qenë një nga llojet më të përdorura të armëve të zjarrit

të shqiptarit. Në dallim nga qendrat e tjera të prodhimit të pushkëve, si Berati, Elbasani dhe Janina në qytetin e Shkodrës, janë prodhuar karajfile me shumicë dhe të zbukuruara në teknikën e filigranit. Armët e zbukuruara në argjend, kushtonin shtrenjtë dhe janë përdorur kryesisht prej shtresave të pasura. Në vitin 1875, në Shkodër filloi të prodhohej edhe martina. Motivet e zbukurimit në armët e krahut janë



**Në tetor 2015,
Muzeu i Ali Pashës në
ishullin e Janinës, u
pasurua me një pushkë
origjinale të Ali Pashë
Tepelenës, e cila është
e larë në ar dhe ka të
gdhendur, emrin e Ali
Pashës dhe vitin 1804.**



Ali Pashë Tepelena ishte një adhurues i madh i armëve dhe nga shënimet e udhëtimit që kanë lënë shumë udhëtarë dhe diplomatë që vizituan pashallëkun e Janinës, njohim se ai mbante shumë prej tyre të varura në mur si objekte zbukurimi.

në relief dhe spikasin mbi sipërfaqen e armës. Teknika e realizimit është e ndryshme, si: e derdhjes, e rrahjes dhe e filigranit. Karajfilet shpeshherë janë zbukuruar edhe me sedef. Armët e gjata takohen të zbukuruara në material argjendi, bronzi, si dhe thjesht prej llamarine, duke shprehur kështu pozitën ekonomike të bartësit. Ka raste që këto zbukurime bëheshin edhe prej ari. Fundi i tytës së armës është realizuar me teknikën e derdhjes. Zbukurimet në argjend pasuroheshin edhe me fildish, në formë drejtkëndëshi, me sedef ose me savat. Në zbukurimin e armëve të krahut me material bronzi është përdorur zakonisht teknika e rrahjes dhe pak mbipunim, ndërsa në armët me zbukurime të thjeshta llamarine, ku veshja realizonte vetëm ruajtjen e drurit janë përdorur skalitje. Veshja e karajfileve është realizuar me paftë argjendi të rrahur, vende-vende të skalitur dhe të zbukuruar me copa në formë drejtkëndëshi, shpeshherë sedefi, ndarja e copëzave të cilat kryhej nëpërmjet një puje. Në faqet anësore të dorezës ishin të vendosura pesë puja të mëdha, ndërsa punimi në paftë realizohej në tërë gjatësinë e saj, që prej fundit të dorezës e deri në majën e tytës. Lidhja e pjesës së drunjtë me tytën kryhej nëpërmjet fashetave, të cilat në pjesën ballore ishin të zbukuruara me incizime motivesh vegjetale.

Për prejardhjen e emrit të pushkës karajfile ekzistojnë tre versione. Varianti i parë është se e kishte marrë këtë emër ngaqë tyta e saj kishte formë karafili, si trombonet e mëvonshme. Varianti i dytë është se, sipas zakonit të kohës, ngaqë ishte si emblemë e dyqanit të armëve një karafil, dhe varianti i tretë, ngaqë kishte të gdhendur, ngjitur me ujkun si shenjë dalluese firmën e prodhuesit nga shtëpia veneciane e Carlo e Figli. (Karli dhe të bijtë), çka ishte shtrembëruar në kariofili në greqisht ose karajfile në shqip. Raste të tilla të shtrembërimit të emrave të firmave prodhuese kanë ekzistuar deri vonë në gjuhën shqipe. Kujtojmë këtu fjalën “mauzer”, për një lloj pushke që përdorte ushtria e rregullt greke, çka në të vërtetë ishte mauzer, emri i firmës në Gjermani apo fjala “belgjik” sërish për pushkë që korrespondonin me pushkët prodhuar në Belgjikë.

Përveç karajfiles së prodhuar në Venecia, kishte dhe armë të këtij tipi prodhuar në vende të tjera të Europës, të quajtura, si karafili prift

dhe karafili maxhar. Emri i këtyre armëve të krahut mendohet se lidhet me emrin e fabrikantit apo firmës “Carlo Figli”. Ato kishin të njëjtin konstruksion njësoj si kërraballiu por të parat kishin namlliat më të shkurtra dhe me nga një stemë. Karafili prift kushtonte afro 700-900 grosh. Ai që kishte stemën si kurorë, që ngjasonte me mitrën e një episkopi quhej karafil prift dhe ai që mbante një stemë tjetër që ka

dhe këngë siç këndonin dikur grekët në shekujt homerikë, mburojës së Akilit. E para armë ishte një pushkë gjatoshë fabrikuar në Versajë, e veshur me damask blu dhe e qëndisur me yje ari, të cilën ia pati dërguar dikur Xhezarit në Shën Gjon të Akrës nganjëllyesi i piramidave. Si vdiq ky pasha, arma i kaloi fatiut Selim III që ia dha si shpërblim trimërie Jusuf Qorr Pashës, tri herë vezir-azem sajë fatit; ky kur

duket se germa S në fjalën Pasha nuk është e alfabetit grek, por një C, që nënkupton germën sigma në greqisht. Prania e kësaj shkronje në pushkë, na shtyn të mendojmë se gdhendësi është një njohës i greqishtes që është shkruar Bibla. Germa C përdoret për në epigrafi dhe në shkrimin majuscule biblik deri në shek. VI dhe përdorimi i saj në tekste në kohën e pashallëkut të Ali pashë Tepelenës do



ardhur nga Hungaria quhej karafil maxhar.

Ali Pashë Tepelena ishte një adhurues i madh i armëve dhe nga shënimet e udhëtimit që kanë lënë shumë udhëtarë dhe diplomatë që vizituan pashallëkun e Janinës, njohim se ai mbante shumë prej tyre të varura në mur si objekte zbukurimi, si duket në tablonë e Joseph Cartëright (1789-1829), pikturuar në mars 1819 dhe publikuar në 1822 (CARTWRIGHT). Joseph Pukëvili në veprën e vet “Historia e ringjalljes së Greqisë” (1825), kur rrëfen rrethimin e Ali Pashës në Janinë, përmend armët që Pashai Tepelena përdori në një rast kur kundërsulmoi ndaj ushtrisë së Pasho Beut. Avxhibashi i solli armët e nishanit, me famë në Epir, ku shqiptarët luftëtarë u kanë ngritur

ishte në Negropont në fund të karrierës së tij të gjatë, ia la me testament Ali Tepelenës. Ky ia besoi më pas Akatit të tij gjakatar, Thanas Vajës; njërit prej shatërve i kaloi pastaj një karabinë që ia kishin dhuruar më 1806 me emrin e Napoelonit; në qemerët e shalës vari mushqetën e Karlit XII të Suedisë, armë me vlerë të paçmuar kundrejt personit që e mbante. E kish pas marrë dikur dhuratë nga Gustav Adolfi, në kohën kur ky monark i tradhtuar prej fatit preku tokën në Prevezë, rrugës që pat ndërmarrë për në Varrin e Shenjtë, shtegtim që i dështoi nga një intrigë diplomatike.

Që në fillim kur u bë i njohur dorëzimi i armës u shkrua se mbishkrimi mbi armë është në greqisht, por një vështrim më i saktë

të ishte diçka e pazakontë, por nëpër epigrafi apo vula ajo gjendet edhe gjatë kësaj kohe, çka na shtyn të mendojmë se mjeshtri skalitës dhe zbukurues i pushkës duhet të jetë nga Janina, ku gjuha greke shërbente si pikë kontakti kulturor midis popullsisë të ndryshme që banonin në Pashallëkun e Janinës.

Identifikimi i sa më tepër objekteve që lidhen me historinë e shqiptarëve, qoftë dhe në muze jashtë Shqipërisë, shpjegimi dhe saktësimi i të dhënave rreth tyre, e pasuron kulturën shqiptare dhe i jep mundësi historisë të shkruhet më mirë, për vendin dhe rolin e shqiptarëve në rajon.

Materiali referuar studiuesit, historianit Dorian Koçi.

Kur AI-ja trajnohet për të dhëna të krijuara nga AI-ja, gjëra të çuditshme fillojnë të ndodhin

Nuk ka kaluar as një vit që OpenAI publikoi ChatGPT, dhe AI-ja gjeneruese tashmë është kudo. Është në klasa, është në reklama, është në argëtim dhe gazetari dhe një numër në rritje i fermave të përmbajtjes të fuqizuara nga AI-ja. AI-ja gjeneruese madje është integruar në motorët e kërkimit, ndërmjetësuesit dhe organizatorët e mëdhenj të uebit të hapur. Njerëzit tashmë kanë humbur punën për teknologjinë, ndërsa karrierat e reja dhe shpesh ngatërruese të lidhura me AI-në duket se janë në rritje.

Megjithatë mbetet për t'u parë nëse do të qëndrojë në terma afatgjatë, të paktën për momentin AI-ja gjeneruese duket se po forcon vendin e saj në jetën tonë dixhitale dhe reale. Dhe ndërsa bëhet gjithnjë e më e kudondodhur, po kështu bëhet edhe përmbajtja sintetike që prodhon. Por në një kthesë ironike, të njëjtat rezultate sintetike mund të jenë gjithashtu kërcënim i madh gjenerues i AI-së.

Kjo sepse mbështetja e ekonomisë në rritje të AI-së gjeneruese janë të dhënat e krijuara nga njeriu. Modelet gjeneruese të inteligjencës artificiale nuk nxjerrin vetëm përmbajtje të ngjashme me njeriun nga ajri; ata janë trajnuar për ta bërë këtë duke përdorur sasi materiale që në fakt janë bërë nga njerëzit, zakonisht të kërkuara nga rrjeti. Por siç rezultojnë, kur ushqeni përmbajtjen sintetike në një model gjenerues të AI-së, gjëra të çuditshme fillojnë të ndodhin. Mendoni për rastin e një bashkimi të dhënash, duke çuar në rezultate gjithnjë e më të ngatërruara, të buta dhe në mënyrë të gjithanshme të këqija. (Në shkurt, studiuesi i të dhënave të Universitetit "Monash", Jathan Sadowski, e përshkroi atë si "AI Habsburg", ose "një sistem që është aq shumë i trajnuar në rezultatet e AI-ve të tjera gjeneruese saqë bëhet një mutant i lindur, me gjasë me tipare të ekzagjeruara, groteske.")

Është një problem që duket i madh. Ndërtuesit e AI-së janë vazhdimisht të uritur për të ushqyer modelet e tyre me më shumë të dhëna, të cilat përgjithësisht po fshihen nga një internet që është gjithnjë e më i ngarkuar me përmbajtje sintetike. Nëse ka shumë hemorragji destruktive, a mundet që gjithçka të shpërbëhet?

Studiuesit e mësimin të makinerive Sina Alemohammad dhe Josue Casco-Rodriguez, të dy studentët të doktoraturës në departamentin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Universitetit "Rice", dhe profesorit të tyre mbikëqyrës, Richard G. Baraniuk, në bashkëpunim me studiuesit në Stanford, kohët e fundit kanë botuar një punim magjepsës, të titulluar "Modelet Gjenerative Vetë-Konsumuese Go MAD".


MAD, i cili qëndron për Çrregullimin e Modelit të Autofagjisë, është termi që ata kanë shpikur për vetë-alergjinë e dukshme të AI-së. Në kërkimin e tyre, u deshën vetëm pesë cikle trajnimit mbi të dhënat sintetike që rezultatet e një modeli të AI-së, sipas fjalëve të Baraniuk, "të shpërthenin".

Është një vështrim tërheqës i asaj që mund të përfundojë të jetë thembra e Akilit e AI-së gjeneruese. Nëse po, çfarë do të thotë e gjithë kjo për njerëzit e rregullt, industrinë në zhvillim të AI-së dhe vetë internetin?

Në lidhje me atë se çfarë përfaqëson ai akronim dhe çfarë përfshin ai fenomen, Richard G. Baraniuk thotë se AI-ja është një fushë e madhe. Inteligjenca artificiale gjeneruese është një pjesë e rëndësishme dhe ajo për të cilën publiku është bërë vërtet i vetëdijshëm kohët e fundit. Modelet gjeneruese gjenerojnë ose sintetizojnë të dhëna. Pra, në ChatGPT një person shkruan një kërkesë të shpejtë, më pas modeli GPT sintetizon tekstin për të shkruar një përgjigje. Ose, nëse jeni duke përdorur gjeneratorë imazhi si DALL-E ose "Stable Diffusion", vendosni një mesazh teksti dhe sistemi gjeneron një imazh dixhital.

Pra, inxhinierët zhvillojnë këto modele gjeneruese. Ata janë në thelb një program kompjuterik dhe programi që duhet të trajnohet. Dhe duhet të trajnohet me sasi të mëdha të dhënash nga interneti. ChatGPT u trajnuar aq shumë nga rrjeti botëror sa mund të gjente OpenAI - në thelb gjithçka. DALL-E u trajnuar në mënyrë të ngjashme për sa më shumë imazhe dixhitale që mund të gjendeshin në ueb.

Dhe thelbi është se gjithnjë e më shumë, modelet e AI-së po trajnohen jo vetëm mbi të dhëna natyrore, ose të dhëna reale me burim nga



bota reale. Tani, ata gjithashtu po trajnohen me të dhëna që janë sintetizuar nga modele të tjera gjeneruese. Pra, rrjedhimisht, ne kemi hyrë në një epokë ku me dashje ose pa dashje, modelet gjeneruese po konsumojnë gjithnjë e më shumë rezultatet nga modelet e tjera gjeneruese. Disa kompani po trajnojnë me dëshirë modele gjeneruese mbi të dhënat sintetike, veçanërisht kur ato janë në një zonë ku thjesht nuk ka mjaftueshëm të dhëna reale. Disa njerëz padashur po stërviten për modelet gjeneruese - për shembull, rezultojnë se shumë nga grupet e mëdha të të dhënave të trajnimit që përdoren sot për të mësuar në të vërtetë përmbajnë imazhe sintetike të krijuara nga modele të tjera gjeneruese.

"Ne e përmbledhim këtë në atë që ne e quajmë një lak autofag. Ky është një term teknik që në thelb do të thotë vetëm vetë-konsumues. Ndoshta mendoni për një kafshë, jo vetëm duke ndjekur bishtin e tij, por duke e ngrënë bishtin e tij. Na pëlqen gjithashtu analogjia me sëmudjen e lopës së çmendur - ushqyerja e lopëve me lopët e tjera të reja në një cikël të përsëritur që çon në patogjenë që shkatërrojnë trurin. Pra, në thelb, puna jonë ka qenë duke studiuar këto sythe vetë-konsumuese dhe të kuptuarit kur modelet shkojnë MAD. Kur ndodhin gjëra të këqija dhe çfarë të bëni nëse nuk dëshironi që të ndodhin gjëra të këqija.

Përmbajtja sintetike tashmë po bën rrugën e saj në grupet e trajnimit të AI-së. Por sa përmbajtje sintetike duhet që një model të shkojë në MAD dhe të prishet? Josue Casco-Rodriguez thotë se padyshim që ndryshon nga modeli në model situata në situatë. Ndërsa Sina Alemohammad shprehet se duhet ta shohim këtë në mënyrë intuitive. "Thuaj se keni 1 miliard të dhëna natyrore dhe keni një pjesë të të dhënave sintetike. MAD nuk do të ndodhë. Por një vit më vonë, nëse keni 1 miliard pjesë të të dhënave sintetike, atëherë patjetër që do të shkojë MAD në pesë përsëritje. Këtë raport e kemi gjetur në modelimin Gaussian".

Studiuesi Baraniuk thotë se, ka absolutisht një prag për çdo model. Por duke kuptuar për DALL-E kundrejt Midjourney, cili duhet të jetë balanca e saktë e të dhënave reale dhe sintetike për të mbajtur gjithçka të sigurt dhe për të mos shkruar MAD, kjo është ende një temë kërkimi. Por tani pyetja për këto modele të mëdha industriale është, çfarë është ajo?

Pra, cilat janë disa nga implikimet për kompanitë e AI? Mund të themi, në mënyrë ideale, se asnjë nga këto nuk futet kurrë në grupet e të dhënave. Por kjo ka ndodhur padyshim, në fund të fundit, njerëzit tashmë po përdorin AI-në për të bërë punën "Mechanical Turk".

Kur jeni duke përdorur padashur të dhëna

sintetike, kjo vlen edhe për praktikuesit, njerëzit që gjenerojnë imazhe dhe i vendosin ato në internet, ndoshta nuk do të jeni të vetëdijshëm për faktin se ajo që prodhoni po shkon për të qenë në trajnimin e ardhshëm të modeleve gjeneruese. Ne e shohim këtë me grupin e të dhënave Laion-5B, për shembull, i cili është përdorur për të trajnuar Difuzionin e Qëndrueshëm: imazhet gjeneruese që njerëzit kanë bërë në të kaluarën po përdoren për të trajnuar modele të reja gjeneruese. Pra, nëse njerëzit prodhojnë të dhëna sintetike, ata duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë fakt. Nga ana e kompanisë, fotografia juaj më e mirë është përdorimi i diçkaje si rrjeti për të qenë në gjendje të zbuloni të dhënat sintetike dhe ndoshta t'i hiqni ato.

Për sa i përket përdorimit të të dhënave sintetike me vetëdije, duhet të jeni të vetëdijshëm se këto modele gjeneruese nuk janë perfekte dhe se shpesh bëjnë gjëra të tilla si sakrificimi i diversitetit sintetik për cilësinë sintetike.

"Ka kompani që, për çfarëdo arsye, mbase është më e lirë të përdoren të dhëna sintetike, ose thjesht nuk kanë mjaft të dhëna reale dhe thjesht tregojnë kujdes. Ata thonë, 'ne do të përdorim të dhëna sintetike'", thotë Baraniuk. Ajo që ata nuk e kuptojnë është se nëse e bëjnë këtë brez pas brezi, një gjë që do të ndodhë është se artefaktet do të përfrohohen. Të dhënat tuaja sintetike do të fillojnë të largohen nga realiteti.

Kjo është gjëja që është me të vërtetë më e rrezikshmja, dhe mund të mos e kuptoni se po ndodh. Dhe duke u larguar nga realiteti po gjeneroni imazhe që do të bëhen gjithnjë e më monotone dhe të mërzhitshme. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me tekstin nëse e bëni këtë - diversiteti i imazheve të krijuara do të bjerë vazhdimisht. Në një eksperiment që zhvilluam, në vend që objektet të përfrohoheshin, të gjitha fotografitë konvergojnë në thelb të njëjtin person. Është krejtësisht e frikshme.

Ndaj është e vështirë për përdoruesit të mbrohen. Nëse këto modele përdoren në një qark si ky, për fat të keq, nga këndvështrimi i përdoruesit, përmbajtja që ata po gjenerojnë thjesht do të bëhet gjithnjë e më e shurdhër. Dhe kjo do të jetë zhgënjyese, apo jo? Ky është vetëm fakt.

Pra, çfarë mund të bëjnë vërtet përdoruesit për të ndihmuar situatën? Një gjë që ata mund të bëjnë është të mos e fikin rrjetin aty ku ekziston. Ka disa anë negative të rrjeteve, por nëse dikush po trajnon një model të ri, ata mund të kërkojnë imazhe sintetike me rrjet dhe t'i hedhin jashtë. Kjo do të ndihmonte vërtet me këtë efekt të pragut për të cilin folëm. Gjëja e dytë që përdoruesit duhet të dinë është se rezultatet e tyre, nëse i vendosin

në ueb, do të rrjedhin pa ndryshim në grupet e të dhënave të trajnimit për sistemet e ardhshme. Disa gjëra janë thjesht të pashmangshme.

Një nga anët negative të rrjetit është se prezanton qëllimisht një objekt. Dhe të kombinuara gjatë brezave, ato mund të shpërthejnë si imazhet e krijuara nga AI-ja.

Alemohammad thotë se problemi është i panjohur. "Ne nuk e dimë se si mund ose do të përforcohet rrjeti. Por padyshim, përfitimet tejkalojnë anën negative. Tani për tani, rrjeti është zgjidhja që na duhet për të gjetur të dhëna sintetike. AI-ja tashmë është duke u integruar në shërbime në të gjithë internetin, veçanërisht në motorët e kërkimit. Dhe motorët e kërkimit, deri në një farë kapaciteti, janë mënyra se si ne bëjmë pothuajse gjithçka në internet, ata janë qendror për ndërmjetësimin dhe navigimin në ueb. Këtu lind dhe shqetësimi për të ardhmen e përdorshmërisë së uebit, nëse modelet e gjeneruara të AI-së integrohen në ueb dhe në jetën tonë të përditshme, dhe më pas fillojnë të degradohen sepse vazhdojnë të gjëlltisnin materiale sintetike".

Nuk ka dyshim se MADness ka potencialin të ulë ndjeshëm cilësinë e të dhënave në internet, thotë Baraniuk, vetëm cilësia e të dhënave dhe puna jonë në këtë punim të veçantë nuk ka trajtuar me të vërtetë llojin e sistemeve të AI-së së përdorur në motorët e kërkimit. Kështu që është pak herët për të thënë. Por ka një punë tjetër atje që në fakt tregon se nëse stërvitni një sistem të ndryshëm, jo-gjenerues të AI-së, një lloj tjetër sistemi AI-je, si ai i përdorur në motorët e kërkimit, nëse e trajtoni atë sistem AI-je, duke përdorur të dhëna sintetike përveç të dhënave reale, performanca në fakt bie.

Pra, kjo mbështet hipotezën se sa më shumë të dhëna sintetike janë atje, në fakt mund të ulin performancën e një morie të tërë mjetes, përfshirë motorët e kërkimit, të cilët janë të trajnuar për të gjitha këto të dhëna atje në internet, disa prej të cilave janë reale, por disa prej të cilave janë sintetike. Njerëzit kanë filluar t'i lidhin ato pika.

Casco-Rodriguez mendon se ping-pongu ndërmjet modeleve mund të jetë vërtet i frikshëm. Dhe meqenëse AI-ja gjeneruese tashmë po përdoret për të bërë gjëra të tilla si gjenerimi i faqeve të internetit tërësisht, mund të përfundoni të keni modele gjeneruese që ju çojnë në rezultate që janë gjithashtu sintetike, që kanë lidhje me uebsajtet të tjera sintetike. Mund të ketë një ekosistem të tërë sintetik që e gjeni përmes motorëve të kërkimit, gjë që është disi e çmendur.

Pra do të bllokoheshë në atë botë, thotë Baraniuk. AI-ja lidhet përsëri me mënyrën se si njerëzit po përdorin ChatGPT për të bërë punën mekanikisht". Në mënyrë që të bëni mësimin e mbikëqyrur, që është një nga mënyrat kryesore që njerëzit mësojnë nga të dhënat për të ndërtuar këto lloje modelesh, ju duhet të etiketoni të dhënat. Ky lloj shënimi i të dhënave ka qenë standardi i artë, por tani ata po zbulojnë se kur i vendosni këto detyra etiketimi në një shërbim si, të themi, "Mechanical Turk", njerëzit nuk po e bëjnë më atë. Ata thjesht po kërkojnë nga sistemet e AI-së që të bëjnë etiketimin për ta. Është më efikas, por na vendos pikërisht në një tjetër nga këto unaza për të cilat kemi folur. Sythe mbi sythe.

"Gjarpri që ha bishtin", Baraniuk hotë se Nuk ka dyshim se kjo mund ta bëjë jashtëzakonisht të vështirë gjetjen përfundimisht të burimit se nga vijën problemet në modelet e AI-së.

Shumë shpejt, do të ketë më shumë imazhe sintetike në internet sesa imazhe reale, do të ketë më shumë faqe interneti sintetike sesa faqe reale. Do të ketë më shumë tekst fals sesa tekst real.

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Gushti 2023 shënon njëzet vjetorin e fillimit të angazhimit të NATO-s në Afganistan, nga gushti i vitit 2003, angazhim i cili përfundoi në gusht të 2021 si rezultat i rënies së Qeverisë së Republikës Islamike të Afganistanit (GIROA) dhe kthimit në pushtet të talebanëve.

Kjo përpjekje e jashtëzakonshme, si në ambicie dhe shtrirje, bashkoi angazhimet dhe kontributet e trupave dhe burimeve të tjera nga afro 50 vende të NATO-s dhe jo të NATO-s, nga e gjithë bota, me qëllimin e ndërtimit të një Afganistani të qëndrueshëm të çliruar nga përdorimi si një strehë e sigurt për terrorizëm. Përgesja e shumta u hasën gjatë rrugës, nga trashëgimia e trazuar e tre dekadave të mosmarrëveshjeve dhe pushtimeve të brendshme pas rënies së monarkisë në 1973, te dinamikat komplekse rajonale dhe sfidat që lidhen me rotacionet e shpeshta të trupave dhe bashkëpunimin civilo-ushtarak në të gjithë lidhjen e sigurisë, qeverisjes dhe zhvillimit.

Për gati 20 vjet, aleatët e NATO-s dhe vendet partnere kishin forca ushtarake të dislokuara në Afganistan nën mandatin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (OKB), që synonte të krijonte kushtet në të cilat qeveria afgane mund të ushtronte autoritetin e saj në të gjithë vendin dhe të ndërtonte kapacitetet e afganëve, forcat e sigurisë kombëtare përfshirë luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar.

Korniza e planifikimit të NATO-s për misionin në Afganistan

NATO mori komandën e Forcës Ndërkombëtare të Asistencës për Sigurinë (ISAF) në gusht 2003, në vazhdim të rrethanave të jashtëzakonshme që ishin krijuar nga sulmet terroriste në Shtetet e Bashkuara të 11 shtatorit 2001. Planifikimi për këto sulme kishte origjinën në territorin e Afganistanit. Si përgjigje, aleatët morën qëndrimin unanimit se sulmet përfundonin një agresion kundër të gjithëve dhe, në përputhje me rrethanat, thirrën Nenin 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut për herë të parë në historinë e NATO-s.

NATO pranoi që herët në planifikimin e saj sfidat që rridhnin nga angazhimi i ISAF për të ndihmuar në krijimin e një mjedisi të mbrojtur dhe të sigurt në të gjithë Afganistanin nën mandatin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Për shembull, një planifikim i tillë pranoi se, ndërsa ISAF mori gradualisht komandën e forcave ndërkombëtare në të gjithë vendin midis gushtit 2003 dhe tetorit 2006, kjo gjurmë në zgjerim do të kërkonte angazhim më të thellë nga aleatët dhe vendet e tjera kontribuuese të trupave të ISAF (TCN), në aspektin politik, vendosmërinë, forcat dhe burimet financiare. Kjo ambicie më e lartë mandatoi gjithashtu zhvillimin e një vizioni afatgjatë për angazhimin e NATO-s në një spektër të gjerë detyrash, si dhe arritjen e një numri në rritje të vendeve jo anëtare të NATO-s që kishin shprehur dëshirën për të kontribuar me forca ose burime në ISAF. Duke u mbështetur në përvojën e saj në ndihmën për t'i dhënë fund luftërave në ish-Jugosllavi, NATO, aleanca kolektive e mbrojtjes, u bë thelbi i një koalicioni më të gjerë të ndihmës për sigurinë.

Ajo që aleatët nuk mund ta dinin në 2003-2006 është se kryengritja do të rezultonte të ishte më e aftë dhe më elastike sesa pritej. Kjo ishte për shkak të dinamikave të brendshme dhe rajonale, duke përfshirë ankesat e nxitura nga përhapja e keq-qeverisjes dhe përdorimi i strehëzave të sigurta në të gjithë rajonin, mbi të cilat NATO kishte ndikim të kufizuar dhe GIROA dëshmoi se kishte një vullnet dhe kapacitet të kufizuar për të kontrolluar. Pavarësisht kësaj sfide të qëndrueshme, NATO qëndroi në kurs, zgjeroi fushën e planifikimit të saj strategjik dhe thelloi angazhimin e saj. Kjo përfshinte trajnimin e Ushtrisë Kombëtare Afgane, ndihmën për të mentoruar Policinë Kombëtare Afgane të sapolindur dhe mbështetjen e përpjekjeve më të gjera të stabilizimit dhe rindërtimit, në koordinim të ngushtë me një sërë aktorësh, veçanërisht Kombet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian.

Për këtë angazhim më të gjerë, aleatët ranë dakord se ishte i nevojshëm një plan gjithëpërfshirës, i cili përcaktonte objektivat dhe detyrat afatshkurtra dhe afatgjata të NATO-s dhe synonte harmonizimin më të mirë të aktiviteteve ushtarake të ISAF-it me dimensionet e tjera të angazhimit të NATO-s dhe me atë të komunitetit më të gjerë ndërkombëtar. Prandaj, përpjekjet e planifikimit në selinë e NATO-s mblodhën forcë dhe kulmuan me miratimin e një Plani Gjithëpërfshirës, Strategjik, Politik-Ushtarak nga Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive (HoSG) të TCN-ve të ISAF-it në Samitin e Bukureshtit të NATO-s në pranverën e vitit 2008.

Hartimi i planit ndoqi nga afër parimet e konceptit të "Qasjes Gjithëpërfshirëse", në lidhje me konsultimin dhe bashkëpunimin me GIROA dhe me palët e tjera të interesuara, si dhe implikimet e tij për koordinimin ndërinstitucional brenda qeverive të TCN-ve. Ndonëse ishte e vetëdijshme se ISAF ishte përgjegjëse vetëm për linjën ushtarake të përpjekjeve, NATO ishte e vetëdijshme nga ana tjetër, se ndihma ndaj popullit afgan për të ardhmen e tij kërkonte një qasje të gjerë për të rivendosur një ndjenjë të përbashkët të vendit. Forcimi i institucioneve shtetërore u ndoqi si një mjet për të ankoruar lidhjet midis popullit afgan dhe rikuperuar kombin e tyre.

Konteksti më i gjerë dhe rrjedha e angazhimit të NATO-s në Afganistan

NATO gjithashtu e kuptoi herët në angazhimin e saj në Afganistan se suksesi i ISAF në ndihmën për krijimin e një mjedisi të mbrojtur dhe të sigurt në Afganistanin jugor dhe lindor, tokat tradicionale të fiseve pashtunë dhe bastionet e talebanëve përgjatë kufijve të Afganistanit me Pakistanin, do të varej nga bashkimi i fiseve pashtunë në mbështetjen e Qeverisë së Republikës Islamike të Afganistanit (GIROA). Do të kërkonte gjithashtu të punohej me Pakistanin për të parandaluar talebanët që të përdorin territoret fisnore në Pakistanin perëndimor si një zonë të pasme për kryengritjen. Për këto qëllime, NATO e bëri Provincën Kandahar qendrën e gravitetit të operacioneve të ISAF dhe ndihmës së NATO-s për përpjekjet më të gjera të stabilizimit dhe rindërtimit, dhe angazhoi Pakistanin

Për gati 20 vjet, aleatët e NATO-s dhe vendet partnere kishin forca ushtarake të dislokuara në Afganistan nën mandatin e OKB-së

Angazhimi i NATO-s në Afganistan



së bashku me SHBA-të në lehtësimin e bisedimeve dypalëshe midis Afganistanit dhe Pakistanit.

Në këtë përpjekje, NATO ishte e ndërgjegjshme për rëndësinë e respektimit të sovranitetit të Afganistanit, promovimit të pronësisë dhe llogaridhënies afgane dhe inkurajimit të GIROA-së për të zbatuar politika gjithëpërfshirëse. Këto synime u ndoqnë në sfondin e korrupsionit të përhapur dhe dinamikave komplekse dhe shpesh të errëta fisnore në lojë midis grupeve të ndryshme etnike dhe midis provincave dhe Kabulit, si dhe mungesës së një dinamike të vërtetshme rajonale midis fqinjëve të Afganistanit që do të krijonte perspektivë e një Afganistani paqësor dhe të begatë, një kauzë e përbashkët e denjë.

Në të njëjtën kohë, angazhimi i NATO-s në Afganistan duhej të përballej me katër kushte që kufizonin së tepërmi efektivitetin e saj: Trashëgimia e trazuar e tre dekadave të konflikteve civile që nga viti 1973, duke përfshirë një dekadë të pushtimit ushtarak sovjetik midis 1979 dhe 1989, që e kishte lënë Afganistanin të shkatërruar dhe popullsinë e tij të copëtuar. Dhuna, trafiku i drogës dhe korrupsioni u bënë endemike, të nxitura nga urretjtet ndëretnike dhe rivalitetet e kryekomandantëve, duke e lënë popullatën e përgjithshme, veçanërisht gratë dhe fëmijët, në një gjendje shpërfilljeje dhe dëshpërimi. Asnjë sasi ndihme dhe asistence ndërkombëtare, sado e qëllimshme dhe e ofruar, nuk mund ta kapërcejë lehtësisht këtë trashëgimi; Dinamika komplekse rajonale, ku lufta e ndërsjellë dhe llogaritjet me shumën zero shpesh dominojnë në kurriz të politikave më gjithëpërfshirëse, dhe ku Afganistani shpesh kishte dorën më të dobët; Kërkesa ushtarake për NATO-n për të komanduar dhe koordinuar rotacionin e rregullt dhe mbështetjen logjistike të kontingjenteve të kontribuar nga afro 50 vende, të dislokuara në një vend të gjerë me një gjeografi komplekse, një infrastrukturë rudimentare komunikimi dhe kushte ekstreme klimatike në dimër dhe verë; Sfidat politike për të mbështetur angazhimin e të gjitha kombeve që kontribuojnë me trupa, të mëdha e të vogla, kundër erërave të kundërta të lodhjes së misionit, mbështetja e luhatshme politike dhe publike dhe kërkesat konkurruese nga misionet e tjera ndërkombëtare për burime domosdoshmërisht të kufizuara.

Deri në vitin 2011, ISAF ishte rritur në madhësi nga rreth 5,000 në vitin 2003 në afërsisht 130,000 trupa. Kjo forcë ishte e mjaftueshme për të mbajtur talebanët në kontroll, por jo për t'i mposhtur ata në mënyrë të pakthyeshme dhe për të parandaluar rilindjen e tyre të rregullt. Pa pranimin politik nga një segment i madh i popullsisë pashtunë, një Afganistan gjithëpërfshirës, demokratik dhe i vetë-qëndrueshëm nuk ishte një qëllim i arritshëm. Duke përfaqësuar rreth 40 për qind të popullsisë afgane, pashtunët ishin mjaft të fortë dhe të bashkuar për të imponuar vullnetin e tyre mbi afganët e tjerë nëpërmjet talebanëve. Fuqia e qëndrueshme e ISAF-it u sfidua nga rotacionet tepër të shpeshta të trupave, mentorëve dhe komandantëve. Kjo praktikë minoi ndërgjegjësimin për dinamikat dhe nevojat lokale, dhe shumë shpesh rezultoi në ndërprerje të përpjekjeve për stabilizim dhe rindërtim dhe në partneritete me trupa afgane që kërkonin vazhdimësi për të zënë rrënjë. Institucionet e dobëta qendrore dhe provinciale ishin të mbingarkuar nga programet shpesh të mbivendosura të aktorëve dhe donatorëve ndërkombëtarë. Siç ka treguar përvoja e Afganistanit, përthithja lokale e ndërtimit të kapaciteteve dhe përpjekjeve më të gjera për stabilizim dhe rindërtim do të mbeten një sfidë në shumë mjedise rajonale. Një dinamikë "e vërtetshme rajonale" mund të kishte të ndihmuar gjithashtu në kapërcimin e politikës së fragmentuar të Afganistanit, duke u ofruar pashtunëve një nxitje për të ecur përtej trashëgimisë së sundimit taleban, dhe për të parandaluar rikthimin tragjik të sundimit të tyre në Afganistan.

Mësime dhe përgatitja nëse vjen thirrja

Në sfondin e një trashëgimie shumë të vështirë dhe një angazhimi sfidues në Afganistan, NATO vendosi instrumentet përkatëse të planifikimit dhe ndoqi, kudo që ishte e mundur, praktikatat e mira të përfshirjes së vërtetë, pronësisë lokale dhe bashkëpunimin rajonal. Rekordit për këtë është i pagabueshëm, por rezultati nuk ishte ai që pritej. Në fund, komuniteti ndërkombëtar nuk ishte në gjendje të siguronte që një Afganistan i vetë-qëndrueshëm të mund të mbizotëronte dhe të parandalonte kthimin e talebanëve në pushtet.

Përgjatë 18 viteve të angazhimit të NATO-s, megjithatë, Afganistani nuk u përdor si një strehë e sigurt për terrorizmin, nuk pati terren për sulme terroriste me viktima masive. Për më tepër, trashëgimia e kujdesit dhe dashamirësisë së treguar ndaj popullatës afgane nga shumë trupa të ISAF-it dhe përkushtimi i tyre për të ndihmuar që Afganistani të bëhet një vend më i mirë për brezat e ardhshëm nuk mund të fshihet nga të dhënat historike, as nga mendjet dhe zemrat e shumë afganëve. ISAF ndihmoi në krijimin e një mjedisi të sigurt për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimit socio-ekonomik. Afganistani ka fituar përqindjen më të madhe të çdo vendi në treguesit bazë të shëndetit dhe zhvillimit gjatë dekadës së misionit të ISAF. Vdekshmëria e nënave u ul dhe jetëgjatësia u rrit. Miliona njerëz ushtruan të drejtën e tyre për të votuar në pesë cikle zgjedhore që nga viti 2004, duke përfshirë zgjedhjet presidenciale dhe të këshillit krahorin të vitit 2014, të cilat rezultuan në krijimin e një Qeverie të Unitetit Kombëtar.

Duke parë përpara, kjo trashëgimi e përzier, në të gjitha nuancat e saj, e ndihmon NATO-n dhe aleatët "të reflektojnë më thellë mbi sfidat e vështira dhe implikimet e misioneve udhëheqëse të mandatuara nga OKB", që synojnë të ndihmojnë në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, parandalimin e konflikteve ose përfundimin e luftërave dhe përgatitjen më të mirë, për misionet të tilla, nëse lind nevoja përsëri. Siç konfirmohet në Konceptin e ri Strategjik të Aleancës, të rënë dakord nga HoSG Aleatë në Samitin e NATO-s të mbajtur në Madrid në korrik 2022, angazhimi i NATO-s ndaj qëllimeve dhe praktikave të menaxhimit të krizave dhe sigurisë bashkëpunuese mbetet i paprekur.



Aleatët e NATO-s mbështesin Slloveninë pas përmbytjeve vdekjeprurëse

Aleatët e NATO-s i ofruan mbështetje Sllovenisë, pasi reshjet rekord, që nisën të premten e 4 gushtit 2023, shkaktuan përmbytje të rënda duke prekur dy të tretat e vendit. Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg zhvilloi bisedë telefonike me kryeministrin Robert Golob, më 7 gusht 2023, duke shprehur ngushëllimet e tij dhe solidaritetin e fortë të NATO-s me Slloveninë.

Stoltenberg shprehu ngushëllimet e tij për popullin e Sllovenisë për humbjen e jetëve dhe shkatërrimin e gjerë të shkaktuar nga përmbytjet e kësaj fundjave. "Me kërkesën e Sllovenisë për ndihmë, qendra e koordinimit të reagimit ndaj fatkeqësive të NATO-s njoftoi menjëherë të 31 aleatët dhe 35 partnerët për nevojat tuaja. E mirëpres që aleatët e NATO-s u ngritën me oferta të menjëhershme mbështetjeje, duke përfshirë helikopterë, ura modulare, ekskavatorë dhe ekspertizë inxhinierike. Ky është solidariteti i NATO-s në veprim. Ne do të vazhdojmë të punojmë ngushtë me ju në ditët dhe javët në vijim. Frekuenca në rritje e motit ekstrem nxjerr në pah ndikimin e thellë të ndryshimeve klimatike. NATO është e përkushtuar për të adresuar

ndryshimet klimatike dhe ndikimin e tij në sigurinë tonë", u shpreh më tej Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg.

Pas kërkesës së Sllovenisë për ndihmë nëpërmjet Qendrës së Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive Euro-Atlantike të NATO-s (EADRCC), Spanja ofroi një helikopter të rëndë CH-47 me deri në 25 personel, përfshirë ekuipazhin dhe stafin mbështetës. Aleatët ofruan gjithashtu mbështetje përmes BE-së dhe mbështetje dypalëshe. Bullgaria, Kroacia, Gjermania dhe Franca kanë ofruar mbështetje përfshirë helikopterë, ekskavatorë, ura të parafabrikuara dhe ekupe inxhinierike. SHBA-të vendosën gjithashtu staf në Lubjanë për të vlerësuar situatën dhe për të përcaktuar nevojat urgjente humanitare.

EADRCC është mekanizmi kryesor i Aleancës për reagimin ndaj emergjencave civile në zonën Euro-Atlantike. Qendra funksionon si një sistem klering për koordinimin e kërkesave dhe ofrimit të ndihmës kryesisht në rast fatkeqësish natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu.

Ndikimi negativ i ndryshimit të klimës në modelet e reshjeve dhe në shëndetin tonë

Ndryshimi i klimës nuk ka të bëjë vetëm me rritjen e temperaturës. Ngrohja e planetit gjithashtu ka pasojë në reshjet me thatësira dhe reshje ekstreme duke u bërë më të zakonshme në pjesë të ndryshme të botës.

Aty ku uji është i pakët, toka thahet duke shkaktuar dështimin e të korrave dhe shëndeti i njerëzve është në rrezik nga mungesa e ujit të pijshëm. Meqenëse ajri më i ngrohtë mund të mbajë më shumë ujë, ndryshimi i klimës po çon gjithashtu në reshje më të mëdha shiu dhe përmbytje ekstreme në zona të tjera. Kjo merr jetë, shkatërron shtëpi dhe infrastrukturë dhe i vë një barrë të madhe ekonomike shoqërive tona.

Sipas vlerësimeve, përmbytjet shkaktuan pothuajse 5600 viktima dhe më shumë se 250 miliardë euro humbje në vendet e BE-së ndërmjet viteve 1980 dhe 2021. Pas përmbytjeve të tilla, temperaturat më të larta të ujit përshpejtojnë rritjen e patogjenëve që vijnë nga uji, gjë që inkurajon shpërthimin dhe përhapjen e sëmundjeve vdekjeprurëse. Dhe efektet negative nuk mbarojnë me kaq, pasi 75% e të prekurve luftojnë me shëndetin e tyre mendor.

Duke pasur parasysh se rreth 170 000 njerëz në Evropë janë të ekspozuar ndaj rrezikut të përmbytjeve çdo vit, dhe se ky numër mund të rritet në 480 000 deri në fund të shekullit për shkak të ndryshimeve klimatike, ndikimi i mundshëm i përmbytjeve në të gjithë kontinentin tonë mund të jetë i madh.

Por zgjidhjet ekzistojnë dhe ndërkohë që autoritetet kombëtare dhe lokale ndërmarrin veprime për të mbrojtur jetën, shëndetin dhe mirëqenien e qytetarëve të tyre, BE-ja po mbështet përpjekjet e tyre me masa për të trajtuar kërcënimet që vijnë nga uji në një klimë në ndryshim.

Në Europë...

Në Milano (Itali), projekti "LIFE Metro Adapt", fitues i çmimit "LIFE Climate Award 2023", u dha planifikuesve urbanë lokalë udhëzime për të aplikuar zgjidhje natyrore për të parandaluar përmbytjet dhe implikimet e tyre shëndetësore. Udhëzimet u zbatuan shpejt, për shembull, një parkim publik makinash u pajis me një sistem të qëndrueshëm kullimi dhe një rrjet kanalesh u rivendos për të rritur kapacitetin e mbajtjes së ujit.



Një burrë duke ecur në një rrugë të përmbytur në Conselice, Itali

Në Roterdamin e ulët (Holandë), rreziku i përmbytjeve është veçanërisht i lartë. Këtu një projekt tjetër i financuar nga BE-ja po përdor zgjidhje natyrore për të mbrojtur qytetarët vendas. Me iniciativën "LIFE Urban Adapt", qyteti ka rivendosur kufijtë e lumenjve, ka krijuar parqe baticash përgjatë brigjeve dhe ka instaluar sisteme të ruajtjes së ujit të shiut. Këto do të mbajnë ujin e tepërt dhe

do ta lejojnë atë të kullojë gradualisht, duke parandaluar përmbytjet.

Ndërkohë, në jugperëndim të Holandës, projekti "LIFE Dutch Dune Revival" ka restauruar rreth 190 hektarë duna me mbështetjen e financimit të BE-së. Si rezultat, njerëzit që jetojnë në zonë tani mund të mbështeten në një mbrojtje natyrore kundër rrezikut të përmbytjeve bregdetare të përkeqësuar nga rritja e nivelit të detit.



LIFE Urban Adapt Tidal Park në Rotterdam, Holandë

“SIPAS VLERËSIMEVE, PËRMBYTJET SHKAKTUAN POTHUAJSE 5600 VIKTIMA DHE MË SHUMË SE 250 MILIARDË EURO HUMBJE NË VENDET E BE-SË NDËRMJET VITEVE 1980 DHE 2021. PAS PËRMBYTJEVE TË TILLA, TEMPERATURAT MË TË LARTA TË UJIT PËRSHPEJTOJNË RITJEN E PATOGJENËVE QË VIJNË NGA UJI, GJË QË INKURAJON SHPËRTHIMIN DHE PËRHAPJEN E SËMUNDJEVE VDEKJEPRURËSE.



Furnizimet e BE-së për ndihmë nga përmbytjet po shpërndahen në Pakistan

“Projekti LIFE NAdapta” po mbron shëndetin e njerëzve në të gjithë Navarrën (Spanjë), duke përmirësuar sistemet lokale të menaxhimit të ujit. Së pari, rreziku i përmbytjeve po zvogëlohet duke rivendosur kufijtë e lumenjve të dëmtuar, duke krijuar mekanizma

paralajmëruar të hershëm dhe duke inkurajuar autoritetet lokale për të zhvilluar plane për mbrojtjen nga përmbytjet. Paralelisht, mungesa e ujit do të trajtohet duke vlerësuar disponueshmërinë e ujit në rajon dhe duke përshtatur planet e menaxhimit të kërkesës

për ujë në përputhje me rrethanat. Gjithashtu, impiantet lokale të trajtimit të ujërave të zeza do të përmirësohen për të parandaluar rrjedhjen e lëngjeve të kontaminuara në lumenj gjatë reshjeve të mëdha dhe përmbytjeve.

...Dhe përtej

Natyrisht, përmbytjet dhe kërcënimet e tjera të lidhura me ujin, të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, të tilla si sëmudjet e shkaktuara nga uji ose mungesa e ujit, nuk janë vetëm çështje evropiane. Uji është thelbësor për jetën, por është kthyer në një rrezik potencial për shëndetin në shumë pjesë të globit.

Kjo është arsyeja pse në mars të këtij viti Kombet e Bashkuara mbajtën Konferencën e tyre të parë të Ujit në 46 vjet, duke mbledhur rreth 10 000 palë të interesuara për të diskutuar zgjidhjet për krizën globale të ujit. Rezultati kryesor i tij, Axhenda e Veprimit për Ujërat, mbledhi mbi 700 angazhime nga qeveritë, kompanitë private dhe OJQ-të për të kontribuar drejt arritjes së Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm 6: “Sigurimi i aksesit në ujë dhe kanalizime për të gjithë”. BE-ja premtoi më shumë se 1 miliard € për të mbështetur veprimet ndërkufitare për menaxhimin e ujit dhe kërkimin shkencor të lidhur me ujin.

Dhe BE po e bën mirë angazhimin, duke ndihmuar vendet anëmbanë globit të përmirësojnë aksesin e tyre në shërbimet e ujërave të ëmbla, kanalizimeve dhe higjienës. Ndihton gjithashtu vendet dhe rajonet e prekura nga përmbytjet e rënda, për shembull duke mbështetur organizatën lokale të monitorimit të përmbytjeve në Afrikën Perëndimore për të rritur kapacitetin e tyre të menaxhimit të fatkeqësive ose duke ofruar ndihmë humanitare për Pakistanin pas përmbytjeve ekstreme të vitit 2022.

BE, në rrugën drejt shndërrimit në një ekonomi neutrale ndaj klimës

BE-ja i ka vendosur vetes objektiva për të reduktuar në mënyrë progresive emetimet e saj të gazeve serrë deri në vitin 2050. Objektivat kryesore të klimës dhe energjisë janë vendosur në: paketën 2020 për klimën dhe energjinë; Korniza e klimës dhe energjisë 2030.

Këto objektiva janë përcaktuar për ta vendosur BE-në në rrugën drejt shndërrimit në një ekonomi neutrale ndaj klimës, siç detajohet në strategjinë afatgjatë të vitit 2050 dhe të sanksionuar në Ligjin Evropian për Klimën.

Komisioni Evropian ka miratuar një sërë propozimesh legislative që përcaktojnë se si synon të arrijë neutralitetin klimatik në BE deri në vitin 2050, duke përfshirë objektivin e ndërmjetëm të një reduktimi neto prej të paktën 55% të emetimeve të gazrave serrë deri në vitin 2030. Paketa propozon rishikimin e disa pjesëve të legjislacionit të BE-së për klimën, duke përfshirë ETS-në e BE-së, Rregulloren e Ndarjes së Përpjekjeve, legjislacionin për transportin dhe përdorimin e tokës, duke përcaktuar në terma realë mënyrat në të cilat Komisioni synon të arrijë objektivat e BE-së për klimën sipas Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane. BE-ja ndjek progresin e saj në uljen e emetimeve përmes monitorimit dhe raportimit të rregullt.

BE-ja i ka vendosur vetes synimin për t'u bërë një shoqëri elastike ndaj klimës deri në vitin 2050, e përshtatur plotësisht ndaj ndikimeve të pashmangshme të ndryshimeve klimatike.

Strategjia afatgjatë 2050

BE-ja synon të jetë neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050, një ekonomi me emetime neto zero të gazrave serrë. Ky objektiv është në qendër të Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane dhe në përputhje me angazhimin e BE-së për veprimin global të klimës sipas Marrëveshjes së Parisit.

Tranzicioni në një shoqëri neutrale ndaj klimës është një sfidë urgjente dhe një mundësi për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë. Të gjitha pjesët e shoqërisë dhe sektorët ekonomikë do të luajnë një rol, nga sektori i energjisë elektrike tek industria, lëvizshmëria, ndërtesat, bujqësia dhe pylltaria.

BE-ja mund të udhëheqë rrugën duke investuar në zgjidhje realiste teknologjike, duke fuqizuar qytetarët dhe duke përafruar veprimet në fusha kyçe si politika industriale, financat dhe kërkimi, duke siguruar njëkohësisht drejtësi sociale për një

tranzicion të drejtë.

Vizioni i Komisionit

Komisioni përcaktoi vizionin e tij për një BE neutrale ndaj klimës në nëntor 2018, duke parë të gjithë sektorët kyç dhe duke eksploruar shtigjet për tranzicionin.

Vizioni i Komisionit mbulon pothuajse të gjitha politikat e BE-së dhe është në përputhje me objektivin e Marrëveshjes së Parisit për të mbajtur rritjen e temperaturës globale nën 2°C dhe për të vazhduar përpjekjet për ta mbajtur atë në 1,5°C.

Si pjesë e Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane, Komisioni propozoi më 4 mars 2020 Ligjin e parë Evropian për Klimën për të përfshirë në ligj objektivin 2050 për neutralitetin e klimës.

Strategjia e BE-së

Të gjitha palët në Marrëveshjen e Parisit janë të ftuara të komunikojnë, deri në vitin 2020, strategjitë e tyre afatgjata të zhvillimit të emetimeve të ulëta të gazeve serrë në mes të shekullit.

Parlamenti Evropian miratoi objektivin e emetimeve

neto zero të gazeve serrë në rezolutën e tij mbi ndryshimet klimatike në mars 2019 dhe rezolutën mbi Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane në janar 2020.

Këshilli Evropian miratoi në dhjetor 2019 objektivin për ta bërë BE-në neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050, në përputhje me Marrëveshjen e Parisit.

BE-ja paraqiti strategjinë e saj afatgjatë në Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) në mars 2020.

Strategjitë kombëtare

Vendeve anëtare të BE-së u kërkohet të zhvillojnë strategji kombëtare afatgjata se si planifikojnë të arrijnë reduktimin e emetimeve të gazeve serrë të nevojshme për të përmbushur angazhimet e tyre sipas Marrëveshjes së Parisit dhe objektivave të BE-së.

Një ngjarje e palëve të interesuara më 10-11 korrik 2018 mbledhi së bashku palë të interesuara nga biznesi, kërkimi dhe shoqëria civile për një diskutim mbi strategjinë e ardhshme të BE-së.

Konsultimi publik nga 17 korriku deri më 9 tetor 2018 mori më shumë se 2800 përgjigje.

Vizioni i Komisionit nisi një reflektim të gjerë të BE-së mbi strategjinë e BE-së, duke përfshirë institucionet e BE-së, parlamentet kombëtare, sektorin e biznesit, organizatat joqeveritare, qytetet, komunitetet dhe qytetarët në të gjithë Evropën.



Arti shqiptar, thesari i vlerë i brigjeve joniane

Arti në Shqipëri është influencuar nga ngjarjet e ndryshme gjatë periudhës historike, ka gjurmë të hershme, dhe vazhdon të zhvillohet.

Gjurmët më të hershme

Fillimet e artit figurativ në truallin e Shqipërisë janë të hershme. Gjurmët e para i përkasin periudhës së neolitit. Nëpërmjet zbulimeve të shumta arkeologjike, në zona të ndryshme të vendit, janë gjetur qindra e mijëra qeramika, terakota, zbulime ne metal etj., që u përkasin fiseve ilire, paraardhësve të drejtpërdrejtë të shqiptarëve të sotëm.

Prodhimet më të hershme janë të thjeshta, për përdorim praktik, por në to shfaqen edhe vlera artistike si në format zoomorfe të enëve ashtu edhe në dekoracionin, gdhendjet dhe elemente të tjerë. Nga shekulli i gjashtë deri në shekullin e tretë p.e.s. në qeramika vizatohen linja dhe figura gjeometrike, forma ndërtohet me siluete më elegante dhe pasurohet me elementë plastikë. Shumë enë të kësaj periudhe, që ruhen sot në muzetë e Shqipërisë, kanë vlera të mirëfillta artistike dalluese vendase, që nuk i ndeshim në artin e fqinjëve të tjerë po aq të lashtë si Helenët, Maqedonasit apo Romakët.

Nga ato enë të lashta, të zbuluara me dekoracione e fraktura plastike, nis rruga e skulpturës në truallin e Shqipërisë, duke u bërë kështu bashkudhëtare me artin e popujve më të hershëm të Evropës.

Tipare më të qarta u dukën sidomos me formimin e qyteteve ilire.

Në qytetet ilire mori zhvillim më të madh skulptura e rrumbullakët si dhe relievi që lidhej me ndërtimin e monumenteve. Në fillim skulptura u zhvillua duke përvetësuar elementë të artit helen, sidomos nga tradita korintike dhe korkyrase.

Më vonë, nga shekulli VI p.e.s., krahas lidhjes me traditën helene, arti ilir fiton veçori te reja, të dallueshme, brenda kuadrantit helenistik. Apolonia dhe Durrahu që u bënë qendrat më të rëndësishme të artit në ato vite, kishin mjeshtrit e shquar vendas që gdhendnin dhe skalisnin në një stil me tipare të veçanta kundrejt veprave të importuara prej qytetërimit helen. Në muzeun e sotëm të Durrësit janë ekspozuar disa skulptura të papërfunduara, të gjetura në atë trevë. Ato dëshmojnë për gdhendjet që janë bërë në truallin shqiptar. Janë zbuluar gjithashtu edhe gjurmë të punishteve të hershme të qeramikës në Apoloni dhe Durrrah. Aty u prodhuan shumë nga enët dhe vazot e bukura të stilit antik që ruhen në muzetë tona. Figurat e pikturuara paraqesin skena të ndryshme mitologjike, pamje nga garat atletike, skena luftimesh etj. Përgjithësisht janë me figura të zeza mbi sfond të kuq (shek. VI-V p.e.s.) dhe me figura të kuqe mbi sfond të zi (shek. IV deri në periudhën helenistike). Pikturimi i figurave është në lëvizje, plot harmoni dhe plasticitet. Në këtë periudhë realizohen edhe shumë statuja të vogla prej bronzi si dhe terakota, ku paraqiten edhe motive laike si dhe figura fëmijësh, barinjsh etj.

Figura me vlerë artistike ndeshim edhe në monedhat e shumta të kësaj periudhe që u realizuan në Apoloni, Durrrah dhe Oriku. Lulëzimi i disa qyteteve ilire dhe i kolonive helene solli një zhvillim të madh të artit që u pasua edhe me shumë llojshmëri formash e teknikash që nga afresket e deri te mozaikët e bukur monokrom dhe polikrom.

Në shekullin I u ngadalësua gjithë ai hov zhvillimi. Pushtimi romak që shkaktoi rënien



ekonomike të qyteteve ilire, la gjurmë të dukshme edhe në art. Ndonëse Roma pushtuese u pushtua vetë prej artit helen, përsëri ndikoi në qytetet ilire me tipare të kulturës së saj provinciale romake. U duk më qartë ndikimi në skulpturë, ku përgjithësisht u ndoq realizmi tipik i kohës, por ndjehet gjithashtu fryma klasike që mbështetet në traditën qindravjeçare. Qendrat kryesore të veprimtarisë artistike mbeten përsëri Apolonia, Dyrrahu, Butrinti etj.

Në vitet e pushtimit romak prej artit zyrtar shkëputet arti i trevave fshatare, ku pasqyrohen motive nga jeta e përditshme. Me praninë e elementëve të thjeshtë artistikë, që dallojnë nga veprat e mëparshme, si dhe me skalitjen e veshjeve dhe emrave ilire, veprimtaria e këtyre viteve mund të vlerësohet edhe si një qëndresë ndaj asimilimit prej pushtuesve më të fuqishëm të kohës.



Galeria e artit ilir



“NË QYTETET ILIRE MORI ZHVILLIM MË TË MADH SKULPTURA E RRUMBULLAKËT SI DHE RELIEVI QË LIDHEJ ME NDËRTIMIN E MONUMENTEVE. NË FILLIM SKULPTURA U ZHVILLUA DUKE PËRVETËSUAR ELEMENTË TË ARTIT HELEN, SIDOMOS NGA TRADITA KORINTIKE DHE KORKYRASE.



Galeria e mozaikëve
të gjetur në Durrës

Zhvillimi i Mozaikut

Në të njëjtën periudhë me artin e trevave fshatare, në truallin e Shqipërisë arriti zhvillimin më të madh edhe arti i mozaikut. Më i hershmi është gjetur në Durrës. I përket shekullit IV p.e.s. dhe është i punuar me gurë zalli shumëngjyrësh. Ka vlera të rralla artistike që shquhen në gjithë veprimtarinë e kësaj gjinie. Quhet “Bukurshja e Durrësit” dhe mund të cilësohet si bukurshja e gjithë mozaikëve që janë zbuluar deri tani në truallin shqiptar, për hijeshinë e figurës dhe mjeshtërinë e realizimit artistik. Në shekullin I, siç përmendëm, u arrit lulëzimi i këtij arti dhe nga gurët e zallit u kalua në kubikë të prerë prej guri, qelqi, mermeri apo balte të pjekur. Mozaikë të

tillë janë zbuluar në Apoloni, Dyrrah dhe Butrint.

Zhvillimi i mëvonshëm i mozaikëve lidhet kryesisht me monumentet paleokristiane. Pas shekullit V motivet e mozaikut ndryshojnë nga modelet e pikturave të hershme, siç është amazonmania në Apoloni, duke u zëvendësuar me figura simetrike që qëndrojnë të shkëputura në sipërfaqe dhe që paraqesin figura kafshësh, shpendësh, pemë frutore, lule e të tjerë simbole të artit paleobizantin. Ruhen edhe sot në gjendje të mirë disa vepra të tilla, siç janë Pagëzoria në Butrint, mozaikët e Linit dhe të Antigonës. Nga gërmimet e deritanishme, është gjetur vetëm një mozaik paretial në Durrës, brenda Amfiteatrit të qytetit, që i përket shekullit VI-VII.

Piktura murale (afresket)

Arti bizantin

Në periudhën e kalimit nga antikiteti i vonë në mesjetën e hershme, skulptura vjen duke u zbehur deri në mohim të plotë nga estetika bizantine, ndërsa arti i pikturës gjeti shprehjen më të lartë artistike. Zhvillim më të madh mori sidomos piktura murale brenda tempujve e krishterë. Kishat u mbushën me afreske dhe ikona që u nënshtroheshin plotësisht kanuneve të rrepta të metropolit. Autorët nuk i firmosnin veprat në atë periudhë, prandaj gjithë ajo veprimtari mbetet ende anonime. Tani në Shqipëri ruhen pak gjurmë nga veprimtaria e më hershme, vetëm disa fragmente. Fatkeqësisht një pjesë e tyre u dëmtua gjatë luftës kundër fesë që u bë në regjimin komunist (1967), duke zhdukur kështu vepra me vlera të rralla për kulturën dhe historinë kombëtare.

Në ato pak fragmente që ruhen ndihen ndikime të stileve perëndimore (Kisha e Rubikut, 1272), si dhe lindore (Vau i Dejës, shek. XIV) të artit bizantin.

Ikonat e shumta si dhe miniaturat në kodikët e Beratit dhe të Vlorës (shek. XI-XIV) janë me vlera artistike dhe i përkasin periudhës së zhvillimit të artit bizantin në Shqipëri.

Në Kishën “Fjetja e Shën Marisë” në Lubonjë të Korçës, ekziston një pikturë murale e Dyfishtë. Kisha është ndërtuar në vitin 1015.

Sipas Theofan Popës “Kjo pikturë, ndonëse mjaft e dëmtuar, paraqet shumë interes për ne, si një nga dokumentet e pikturës tonë më të vjetër, që dokumenton historinë e traditave të arteve figurative të vendit tonë”.

Arti pas bizantin

Gjatë shekullit XVI, ndonëse ende nën

pushtimin osman, u realizuan vepra të reja artistike në pikturë, në stilin pas bizantin. Personaliteti më i shquar i kësaj periudhe është Onufri (shekulli XVI).

Pikturat e tij dallohen për ngjyra të pasura dhe nuanca dekorative, për realizimin e tipave interesantë me gjendje tragjike, si dhe për futjen e disa elementëve etnografikë kombëtarë që do t'i shohim më qartë edhe te pasardhësit e tij; i biri Nikolla (shek. XVI) si dhe te piktorët e shquar David Selanicas (shek. XVIII), Kostantin Shpataraku (shek. XVIII), dhe te të mëvonshmit vëllezërit Kostandin dhe Athanas Zografi (shek. XVIII), familja Katro (shek. XVIII) etj., që zbukuruan mjaft kisha në Shqipëri dhe në vendet fqinj.

Në Shqipëri është bërë edhe vazhdon të bëhet një punë e kujdesshme për veprat e artit pas bizantin, pasi ato çmohen si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë më të pasur kombëtare. Vazhdojnë ende hulumtimet për zbulimin e autorëve të tjerë si dhe restaurimi i veprave të dëmtuara gjatë shekujve. Deri tani janë hapur disa ekspozita me vepra të këtij arti si në Paris (1975), Romë (1985), Nice (1993) etj., të cilat kanë ngjallur interes të shumtë te specialistët e artit. Ekspozitat janë shoqëruar me botime të ilustruara dhe me komente të shumta nga shtypi i huaj. Veprat më të çmuara të këtij arti ruhen në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë, Muzeun “Onufri” Berat, Muzeun Historik Kombëtar, Galerinë Kombëtare të Arteve si dhe në muze të tjerë në Tiranë dhe qytete të tjerë të vendit. Në Korçë është ngritur edhe një muze privat, i vetmi deri tani në Shqipëri, që ruan një koleksion të pasur me vepra të artit pas bizantin.



“Little Boy”, hija e tmerrit të Luftës së Dytë Botërore

Më 6 gusht të vitit 1945, gjatë Luftës së Dytë Botërore është hedhur bomba e parë atomike mbi qytetin e Hiroshimës në Japoni, e cila është pasuar nga një tjetër më 9 gusht në Nagasaki.

Bomba “Little Boy” është hedhur nga avioni B-29 “Enola Gay” i Flotës Ajrore të Shteteve të Bashkuara. Bomba me uranium, me forcën e 13 mijë TNT ka shkatërruar 70 për qind të Hiroshimës, duke krijuar nxehtësi prej 3.000 centigradësh.

Bomba atomike ka rrafshuar me tokën çdo gjë në një diametër prej 1.5 kilometrash, ndërsa ka shkaktuar 80 mijë të vdekur vetëm në fazën e parë dhe 140 mijë deri në fund të vitit 1945 nga djegiet dhe helmimet.

Kodrat përreth qytetit kanë kufizuar përhapjen e forcës shkatërruese nga rrezatimi, të bombës me fuqi 22 mijë TNT të hedhur nga një lartësi 500 metra, megjithatë rreth 70 mijë persona kanë humbur jetën në fazën e parë dhe gjysma e qytetit është shkatërruar.

Perandori i atëhershëm i Japonisë, Michinomiya Hirohito në mesazhin e tij, më 15 gusht, ka deklaruar dorëzimin e vendit të tij pa kushte, duke thënë se “vazhdimi i luftës do ta shkatërronte popullin japonez”.

Hiroshima është vënë në shënjestër për shkak të bazave ushtarake, kurse Nagasaki për shkak të industrisë së rëndë.

Hedhja e bombës në Nagasaki i ka dhënë fund zyrtarisht betejave që kanë vazhduar në Paqësor.

Sipas japonezëve numri i të vdekurve është gjysmë milion

Sipas shifrave zyrtare të Komitetit të Projektit Manhattan, të themeluar për të zhvilluar armë bërthamore për SHBA-të, para bombardimit në Hiroshima jetonin 255.000 njerëz.

Në fazë të parë në Hiroshima humbën jetën 66.000 persona dhe u plagosën 69.000 të tjerë.

Ndërsa në Nagasaki ku jetonin 195.000 njerëz humbën jetën 39.000 dhe u plagosën 25.000 të tjerë.

Deri në fund të vitit numri total i të vdekurve është rritur në 135.000, ndërsa në Nagasaki 75.000. Por japonezët njoftuan se vdekja në dy qytetet është afër 500.000.

Hibakusha. Të dëmtuarit nga katastrofa



atomike, të njohur si “Hibakusha”, u përballën me plagë të tmerrshme.

Bombat atomike përveç ndikimit shkatërrues si bombat konvencionale, zgjeruan edhe më tej diametrin e efektit si rezultat i reaksioneve të nxehtësisë dhe rrezatimit.

Këto bomba shkaktuan degormime dhe sëmundje të cilat vështirë të trajtohen përfshirë edhe kancer tek shumë njerëz.

Depresioni psikologjik dhe plagët e

viktimave vazhdojnë edhe në ditët e sotme.

Mosha mesatare e Hibakushave ka arritur në 82 ndërsa numri i tyre zvogëlohet gjithnjë e më tepër. Ata shprehin mesazhin e tyre për heqjen dorë nga armët bërthamore çdo gusht.

Bota nën hijen e luftës bërthamore

Krahas dorëzimit të Japonisë, bombat atomike, të cilët përbënin një pikë kthese të luftës, shkaktuan edhe transformimin e marrëdhënieve ndërkombëtare. SHBA dhe Bashkimi Sovjetik

formuluan mënyrën e montimit të bombave të fuqishme me hidrogjen në raketa balistike ndërkontinentale (ICBM), me çka hodhën hapin drejt epokës së “përdorimit të forcës ekstreme”. Mes viteve 1960 dhe 1990, bota hyri në periudhën e “Luftës së Ftohtë” që u kaloi nën hijen e luftës bërthamore, por gjatë së cilës dy fuqitë bërthamore asnjëherë nuk morën guximin t’i hapin luftë “të drejtpërdrejtë” njëra-tjetrës.



Jeta përtej dallgëve, udhëtimi biblik i shqiptarëve

32 vjet nga eksodi i shqiptarëve me anijen Vlora, brenda së cilës ndodheshin 20 mijë shqiptarë të përvuajtur të cilët trokitën në dyert e Italisë, duke i dhënë Evropës imazhet e para të një shoqërie jo vetëm të varfër por dhe të izoluar nga bota prej regjimit komunist. Për këdo që e ka jetuar këtë kalvar tranzicioni është më e kuptueshme se sa kanë ndryshuar gjërat që nga ajo kohë. Ndryshime që më së shumti i dedikohen asaj furie njerëzore që vinte nga mungesa e shpresës dhe që e kërkonte të ardhmen tek Evropa, jo thjesht si imazh begatie e mirëqenieje, por dhe si imazh i demokracisë së munduar për 50 vitesh.

Udhëtimi i 20 mijë shqiptarëve që kishin mbushur anijen “Vlora” në Durrës, i ngjante një udhëtimi biblik drejt tokës së premtuar, të cilën e ndeshën në brigjet e Barit, prej nga u mirëpritën nga një popull fisnik si italianët e që u hapi dyert dhe zemrën. Kjo dashamirësi u dëshmuar së pari nga Enrico Dalfino, kryebashkiakut të Barit në vitet 90-91, i cili zgjodhi të mirëpriste eksodin edhe pse kundërshtoi qeverinë.

Nisja e anijes Vlora drejt Puglias ishte vala e dytë e eksodit të shqiptarëve para 32 vitesh.

Vala e parë ishte ajo e ambasadave, ndërsa regjimi komunist ishte ende në këmbë. Këto ishin rrugëtimet e para të shqiptarëve drejt Evropës pas gati 50 vitesh izolimi. Ishte një rrugëtim shprese, se dhe vendi i tyre do të bëhej: me punë dhe me djersë, me dinjitet dhe drejtësi, me liri dhe të drejta, me mundësi për ta krijuar të ardhmen këtu.

Ndërsa hedhim sytë pas, nga gjithë ato energji njerëzore të ndrydhura e që shpërthyen në atë eksod masiv, shohim se ende ka shumë për të bërë që ato aspirata të bëhen realitet i pakthyeshëm.

Më 8 gusht 1991, anija shqiptare e mallrave “Vlora”, mbërriti në portin e Barit, e tej mbushur me refugjatë nga Shqipëria.

Emigrantët fillimisht u mbyllën në stadiumin e vjetër “Stadio della Vittoria”, dhe më pas u riatdhesuan për në Shqipëri.

Anija “Vlora”, mbërrin nga Durrësi, gati pa karburant, mundohet të hedhe spirancën në Brindisi, por nuk pranohet dhe drejtohet për në Bari.

Në bord ka edhe njerëz të armatosur, përveç emigrantëve në arrati nga 45 vjet regjimi komunist, tanimë i shkërmoqur, ka dhe gra e fëmijë.

Anija kishte mbërritur në port nga Kuba, plot me sheqer, dhe shkarkimi i saj nuk kishte përfunduar akoma, kur e pa që po afrohej ky det njerëzish.

Sa njerëz ndodheshin në bord?

Gazetat e 9 gushtit 1991 shkruanin se bëhej fjalë për 11 000 persona, ndërsa në kronikat e sotme flitet për 20.000. Një gjë është e sigurt, ishte një mori njerëzish që nuk po kuptonin as vetë se çfarë po bënin dhe se çfarë i priste në anën tjetër për të cilën kishin ëndërruar shumë.

Në orën 11:30 lumi i njerëzve ndodhet në platformë. Kërkojnë bukë dhe ujë. Policia i drejton të gjithë në stadiumin e vjetër të futbollit, në pritje të vendimeve.

Kryeministri, Giulio Andreotti, dikton nga Roma këtë deklaratë: “Nuk jemi absolutisht në gjendje të mirëpresim shqiptarët që po dynden në brigjet italiane dhe vetë qeveria e Tiranës është dakord me ne, që ata duhet të riatdeshohen në vendin e tyre”. Në stadium plas revolta.

Më të rinjtë shkulin pllakat e shkallëve dhe hedhin gurë kundër policisë. Përleshje të ashpra zgjatën tre ditë, më të dhunshmet qenë ato të së dielës, më 11 gusht, me 40 të plagosur mes policisë dhe një numër i pacaktuar mes protestuesve.

Shqiptarëve u jepet ushqimi dhe uji nga qielli, me thasë të hedhur nga helikopterët.

Ndërkohë organizohet operacioni më i madh i riatdhesimit në historinë e Republikës së Italisë. Në të marrin pjesë 11 avionë ushtarakë C130 dhe G222, së bashku me tre “Super80” të “Alitalia-s” dhe motobarka si “Tiepolo”, “Palladio” dhe “Tiziano”,

Në fillim shumë prej tyre nuk e dinin se po i kthenin. Të riatdhesuarit qenë 17 mijë e 400, më shumë nga pasagjerët e Vlorës (e përsërisim sipas shifrave të asaj kohe), sepse u riatdhesuan edhe imigrantë që kishin mbërritur me anije të tjera.

Mbetën në Itali 1 500 vetë që kishin paraqitur kërkesë për



strehim politik.

Gianni De Michelis, ministër i Punëve të Jashtme, fluturoi për në Tiranë për të ilustruar një plan italian ndihme: 90 miliardë lireta për ushqime, 60 miliardë për industrinë dhe furnizimet për hapjen në tetor të shkollave, dhe bashkëpunim në rendin publik për të parandaluar ikje të tjera.

Në Parlament pati polemika mbi metodat e rrepta, madje brutale, të këtij operacioni. Shumë më pak mbi thelbin e tij. Në një konferencë shtypi deputetët e PDS (Partia Demokratike Italiane e sotme) “megjithëse kuptojmë vendimin e dhimbshëm për

riatdhesimin e refugjatëve në Shqipëri”, ata denoncuan “zgjedhjen e pamenduar për të mos respektuar të drejtat e njeriut, duke u mohuar atyre një asistencë të denjë.”

Megjithatë, në ato vite, Italia në përgjithësi dhe Puglia në veçanti dhanë prova shumë të mëdha mikpritjeje.

Më pas mes Romës dhe Tiranës do të lidhet një marrëveshje model, e cila arriti të lehtësojë emigracionin e rregullt të shumë shqiptarëve. Por historia e anijes “Vlora”, e 8 gushtit të vitit 1991, do të mbetet ëndrra e frikshme e zhegut të gushtit të largët të 32 viteve më parë.



PSE DUHET TË ZGJEDHIM AKADEMINË E FORCAVE TË ARMATOSURA?

- **TRAJTIM FINANCIAR MUJOR
PËR TË GJITHA VITET E STUDIMIT**
- **PUNËSIM DHE PENSION
SUPLENTAR TË SIGURTË**
- **AKOMODIM DHE TRAJTIM
USHQIMOR FALAS**
- **TARIFË STUDIMI
0 LEKË NË VIT**

